FESTA E FLAMURIT KOMBËTAR

NGA TUBIMI FESTIV I BASHKIMIT

TË INTELEKTUALËVE SHQIPTARË NË ZVICËR

B I S H Z - V A I S - U I A S

BASHKIMI I INTELEKTUALËVE SHQIPTARË NË ZVICËR
VEREINIGUNG DER ALBANISCHEN INTELLEKTUELLEN IN DER SCHWEIZ
UNION DES INTELECTUELS ALBANAIS EN SUISSE
UNIONE INTELLETTUALI ALBANESI IN SVIZZERA

S O L O TH U R N, 24 N Ë N T O R 2013

Më 24 Nëntor 2013, në Langendorf të Solothurnit (Zvicër) Bashkimi i Intelektualëve Shqiptarë në Zvicër, organizoj një manifestim, kushtuar 28 nëntorit, festës së Flamurit dhe Pavarësisë së Shqipërisë. Në këtë tubim festiv (në praninë e bashkatdhetarëve të ftuar) u përuruan edhe librat e katër autorëve: 1.Luljeta Selimi, "Rrëfime tronditëse - Femrat e dhunuara gjatë luftës në Kosovë; 2. Xhevat Rexhaj, "Epoka e shënuar apo Rugova, Flamuri, LDK-ja; 3. Lebit Murtishi, Poezi dhe dy monodrama; 4. Gani Qarri, a."Mallkim shekujsh"-libër me Poezi, b."Krijuesit e Historisë" libër në Prozë dhe c."Vrasje Idealesh" libër në Prozë. Programi festiv u hap me intonimin e himnit Kombëtar, ndërsa fjalën përshëndetëse e mbajti Kryetari i Bashkimit të Intelektualëve Shqiptarë në Zvicër, z.Abas Fejzullahi. Një vështrim për veprimtarinë e BISHZ e bëri Dr.Sc.Ahmet Xhigoli, ndërsa për librat e katër autorëve,

folën: Sheradin Berisha, Saranda Ademi, Hamzë Morina, Gani Qarri, Idriz Mehmeti, Abas Fejzullahi dhe Isuf Ismaili. Në pjesën përmbyllëse të promovimit të librave foli edhe Zv.ambasadori i Republikës së Kosovës në Zvicër, z. Mustafë Xhemaili. Gjatë këtij tubimi u shfaq edhe një program i pasur muzikor. Kënduan Hekuran Rexhepi me djalin Ridvanin dhe vajzën Hysnijen, nxënësja Fionda Gjoni interpretoj një melodi me violinë, ndërsa motrat Qëndresa dhe Albulena Osmani që përfaqësonin Forumin e Femrës Shqiptare "Lirija" nga Lozana (nën përkujdesjen e koreografes Saranda Ademi), prezentuan disa valle burimore shqiptare. Në pjesën e fundit të tubimit organizatorët (BISHZ) ndanë mirënjohje për disa dëshmorë(e) dhe veprimtarë që dhanë kontribute të veçanta në fusha të ndryshme në Zvicër, si dhe shtruan një darkë për të gjithë pjesëmarrësit e këtij tubimi festiv.

(Sheradin Berisha, kryeredaktor i pashtriku.org, 02. 12. 2013)

* * *

RR J E DH A E P R O G R A M I T

B I S H Z - V A I S - U I A S
BASHKIMI I INTELEKTUALËVE SHQIPTARË NË ZVICËR
VEREINIGUNG DER ALBANISCHEN INTELLEKTUELLEN IN DER SCHWEIZ
UNION DES INTELECTUELS ALBANAIS EN SUISSE
UNIONE INTELLETTUALI ALBANESI IN SVIZZERA

Solothurn, 2013-10-30

F T E S Ë

Për pjesëmarrje në programin e organizuar nga BISHZ, kushtuar Flamurit Kombëtar dhe përurimin e librave nga katër autor më, 24 Brymor(Nëntor) 2013 me fillim në ora 14:00-20:00

Të dhënat lidhur me programin:

PJESA E PARË 14:00-16:30

1.PËRURIMI I LIBRAVE NGA AUTORËT:

- **Luljeta Selimi**
  RRËFIME TRONDITËSE - FEMRAT E DHUNUARA GJATË LUFTËS NË KOSOVË -
  "Berichte während des Kosova-Kriges Vergewaltigter Frauen"
  Përurimi bëhet edhe në Zürich më datën 2013-11-25 në ora 18:00 në Albanische Bibleothek in der Schweiz- BIBLEOTEKA SHQIPTARE NË ZVICË- ZÜRICH, Drejtor - Skënder Rexhepi, tel: 079 634 73 14 & 044 480 03 51 adresa: Hohlstrasse 610 8048 Zürich.

- **Xhevat Rexhaj**
  EPOKA E SHËNUAR APO RUGOVA,FLAMURI, LDK-JA

- **Lebit Murtishi**
  POEZI DHE DY MONODRAMA

- **Gani Qarri**
  1."Mallkim shekujsh" -libër me Poezi.
  2."Krijuesit e Historisë"libër në Prozë dhe
  3."Vrasje Idealesh" libër në Prozë

PJESA E DYTË 17:00-18:30

FESTA E PËRBASHKËT KUSHTUAR FLAMURIT KOMBËTAR

PJESA E TRETË 18:40-20:00 DARKA E PËRBASHKËT

Adresa: **RISTORANTE PIZZERIA TRAUBE**
Schulhausstrasse 9
4513 Langendorf
Tel.032 622 20 22

Udhëzime: Në Solothurn merrni rrugën Wiesensteinstrasse drejtimi për Langendorf shifni tabelen në foto në shtyllë, ktheheni menjëherë majtasë pas kalimit të shenjave për kalimin e këmëbsorëve 50 m largësi gjindet Restoranti majtasë dhe vendi për lënjen e automjeteve.

LAJMËRIMI PËR PJESËMARRJE

1. **Lajmërimi për pjesëmarrje dërgohet me shkrim deri më ditën e premte 15 Brymor (Nëntor) 2013**
2. **Në lajmërim duhet shënuar emri dhe mbiemri i secilit pjesëmarrës, për sigurimin e vendeve**
3. **Secili pjesëmarrës i paraqitur shpenzimet e darkës i merr përsipër**
4. **Darka do të jetë sipas regjistrit të kuzhinës(Byfe meny)- vetshërbehet secili për vete**
5. **Për një pjesëmarrës çmimi i darkës me pije(pa alkohol) kushton: Fr.30**
6. **Pas datës 15-11-2013, çdo lajmërim s`do të pranohet për pjesëmarrje.**
7. **Referuesit, vështrimet e bëra me shkrim, për librat që përurohen, duhet t`i dërgojn përmes postës elektronike, më së voni deri më datën 2013-11-15.**
8. **Programin lidhur me përurimin e librave dhe Festën e Flamurit Kombëtar, të lajmëruarit në afatin e caktuar deri më datën 2013-11-15, do t`ju përcjellet përmes postës elektronike më së voni deri më datën 2013-11-20.**

Luteni që të dhënat lidhur me pikat 1-2 dhe 7 t'i dërgoni përmes adresës-postës elektronike në vijim:
E-Mail: afejzullahi@yahoo.com,abas_fejzullahi@hotmail.ch

Me nderime Abas Fejzullahi, , kryetar

B I S H Z - V A I S - U I A S
BASHKIMI I INTELEKTUALËVE SHQIPTARË NË ZVICËR
VEREINIGUNG DER ALBANISCHEN INTELLEKTUELLEN IN DER SCHWEIZ
UNION DES INTELECTUELS ALBANAIS EN SUISSE
UNIONE INTELLETTUALI ALBANESI IN SVIZZERA

2013-11-24

Programi lidhur me përurimin e librave nga katër autor

Pjesa e parë 14:00- 16:30

Nr.	Koha	Përmbajtja	Paraqet *** Lexon
1.	14:00	Himni Kombëtar dhe nderimi i Festës	Himni
2.	14:01	Fjala përshëndetëse dhe hapja e programit të punës.	Abas Fejzullahi
3.	14:05	Një vështrim i shkurtër për veprimtarin e BISHZ	Dr.Sc.Ahmet Xhigoli
5.	1	➢ LULJETA SELIMI RRËFIME TRONDITËSE – FEMRAT E DHUNUARA GJATË LUFTËS NË KOSOVË	
1:1	14:10	Jetëshkrimi i autorës Luljeta Selimi	Sheradin Berisha
1:2	14:15	Vështrimet: Lebit Murtishi: Një Monument prej Trishtimi...	Saranda Ademi

1:3	14:20	Sheradin Berisha: DHUNIMI I FEMRAVE GJATË LUFTËS NË KOSOVË - KRIM I PANDËSHKUAR!	Sheradin Berisha
1:4	14:25	Hamzë Morina: Luljeta Selimi „Rrëfime tronditëse“	Hamzë Morina
1:5	14:30	Gani Qarri: "Tragjedi me dhembje që vazhdojnë"...	Gani Qarri
1:6	14:35	Fjala e autorës: Luljeta Selimi	Luljeta Selimi
	14:40	Freskim me ujë e me një këngë	Hekuran Rexhepi
			Fatime Sokoli !
2:1	2	➢ Xhevat Rexhaj EPOKA E SHËNUAR APO RUGOVA,FLAMURI, LDK-JA	
2:1	14:45	Jetëshkrimi i autorit ** Xhevat Rexhaj	Saranda Ademi
2:2	14:50	Vështrimet:Abas Fejzullahi: “ Publicistika dhe përditshmëria ...”	Abas Fejzullahi
2:3	14:55	Mr.Shaip Latifi, redaktor i librit dhe vështrimi i tij me rastin e përurimit	
	3	➢ Lebit Murtishi POEZI DHE DY MONODRAMA	
3:1	15:00	Jetëshkrimi i autorit *** Lebit Murtishi	Saranda Ademi
3:2	15 :05	Vështrimet:Idriz Mehmeti: Njohja afria dhe bashkëpunimi me Lebitin	Idriz Mehmeti
3:3	15 :10	Gani Qarri: “Vuajtja për Diellin e munguar *apo* Lebit Murtishi dhe stinët pa Diell	Gani Qarri
	4	➢ Gani Qarri 1."Mallkim shekujsh" -libër me Poezi. 2."Krijuesit e Historisë"libër në Prozë dhe 3."Vrasje Idealesh" libër në Prozë	
4:1	15:15	Jetëshkrimi i autorit *** Gani Qarri	Dr.Sc.Ahmet Xhigoli
4:2	15:20	Vështrimet: "Krijuesit e historisë së përvjetorëve të mëdhenj"	Abas Fejzullahi
	15:25	Një këngë e pakëz freski	Hysnije Rexhepi
6.	15:30	Një Dokumentar nga autorja Luljeta Selimi	Film
7.	16:00	Nderimet e BISHZ	Abas Fejzullahi Dr.Sc.Ahmet Xhigoli
8.	16 :05	Bashkëbisedim: Pyetje dhe pergjegje	Të gjithë
9.	16 :30	Përfundimi dhe mbyllja e pjesës së parë të programit	Abas Fejzullahi
10	16 :30	Një rend llafe dhe një rend kafe...	BISHZ
		PJESA E DYTË 17:00-18:30	
11.	17:00	Disa fjalë kushtuar Festës së Flamurit Kombëtar	Abas Fejzullahi
12.	17:05	Këngë gëzim e hare ****Hekuran Rexhepi & Hysnije-F.S- Rexhepi...	Hysnije Rexhepi..
13.	17:30	Fjala e pjesëmarrësve në festën e perbashkët	Të gjithë
14.	18:00	Këngë gëzim e hare	Program i zgjedhur
15.	18:30	PJESA E TRETË 18:40-19:30 DARKA E PËRBASHKËT	
16.	19 :30	Këngë e valle popullore	
17.	19 :55	FALËNDERIM PËR PJESËMARRËJE DHE MBYLLJA E PROGRAMIT	Abas Fejzullahi
18.	20 :00	Sipas dëshirës kush don mund të vazhdoj ndejen, biseden apo vallëzimin	

* * *

BIOGRAFIA E LULJETA SELIMIT

Të nderuar bashëkatdhetarë, zonja dhe zotrinj,

Duke ju përshëndetur të gjithë juve, organizatorët e këtij tubimi festiv dhe katër autorët e librave, që po i promovojmë sot, më lejoni që fillimisht t'ju uroj 28 nëntorin - këtë ditë të madhe kombëtare.

Luljeta Selimi ka lindur më 19. 09. 1969 në Prishtinë. Është bijë e dy prindërve intelektualë - babai inxhinier dhe nëna farmaciste. Përveç shkollës

fillore, ajo ka mbaruar shkollën e mesme, fakultetin për Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, fakultetin e gazetarisë dhe shkollimin e lartë mjekësoro - shëndetësor, drejtimin "Gjinekologjia, Tramutologjia dhe shfaqja e saj tek pacientët" në Holndë. Pas luftës ka specializuar në Traumatologji në Universitetin e Trierit në Gjermani, te Prof.Lutz Besser, si dhe ka kryer disa kurse për psikiatri dhe është e pajisur me disa diploma dhe certifikata në këto fusha.

Në vitin 2000 për çështje profesionale ka qëndruar në Australi, pastaj një vjet (në vitin 2001) ka qenë për specializim në Holandë, në vitin 2007 ka bërë një specializim 3 mujor në Costermano, Verona të Italisë, në Institutin Don'Bosko, ku ka pasur trajnime dhe demostrime të drejtë për drejta me pacientë të këtij instituti përpara profesorëve.

Luljeta Selimi merret edhe me krijimtari letrare. Ajo me përkushtim shkruan poezi dhe tregime dhe në këto fusha ka marrë disa çmime. Gjithashtu ajo angazhohet edhe në krijimin e grupeve letrare në mënyrë që artëdashësve të rinj t'u jepet mundësia për ta shprehur talentin e tyre.

Deri me tani ajo ka botur këto vepra letrare:

1. "Lindje pa emër", poezi,

2. "Tre muajt e Anitës", roman,

3. "Venitja", roman,

4. "Udhëkryqi" roman.

5. “Kosova në shifra - 2003” bashkautor me gjermanin Armin Matiu,

6. "Rrëfime tronditëse - femrat e dhunuara gjatë luftës së Kosovës", publicistikë. Ky libër është përkthyer në gjuhën angleze, gjermane dhe italiane.

Po ashtu ka punuar edhe në 12 libra shkencorë - të karakterit profesional, qoftë vetëm, qoftë me grup autorësh.

* * *

Për më tepër, Luljeta Selimi ka punuar si gazetare dhe zëdhënëse në Entin e Statistikave të Kosovës, ndërsa tani punon si Udhëheqëse e Statistikave të Shëndetësisë në Agjencionin e Statistikave të Kosovës, dhe si drejtoreshë në organizatën humanitare - joqeveritare të gruas "Jeta në Kastriot", e cila ndihmon femrat e dhunuara gjatë luftës në Kosovë. Në këtë kuadër ajo ndihmon: gratë e veja, fëmijët jetim, familjet e dëshmorëve, familjet e invalidëve dhe femrat kryefamiljare.

* * *

Kjo organizatë humanitare, të cilën e drejton Luljeta Selimi, ka vepruar edhe gjatë luftës në Kosovë, ndërsa zyrtarisht është regjistruar në maj 2001 dhe ka një ekip prej 15 vetave, 11 mjekëve dhe 4 infermiereve, të cilat punojnë vullnetarisht, pa u ndihmuar fare nga institucionet e shtetit. Këtë organizatë e mbështesin kryesisht njerëzit vullnetmirë dhe donatorë të ndryshëm, dhe me ndihmat e tyre trajtohen plagët trupore dhe shpirtërore të femrave të dhunuara gjatë luftës në Kosovë (1998 - 1999).

Sheradin Berisha - Solothurn, 24. 11. 2013

(Vështrim librit „Femrat e dhunuara gjatë Luftës në Kosovë " 2013-11-13)

Një Monument prej Trishtimi...

Lebit Murishi

Pranë librit të autores Luljeta Selimi, pranë këtij rrebeshi trishtimesh mitike, po të kisha lindur jashtë këtij planeti, do më dukej vetja spektator rrëfimesh, spektator përrallash, sajuar e stisur nga mendje të trillta - për të trembur kohët që kurrë të mos vijnë, që kurrë të mos shkelin në ato lëndina që klithin lëndinat, që kurrë të mos kthehen në ato trishtime ku klithin trishtimet...

Këtu ndeshen për vdekje engjulli me djallin dhe jeta me vdekjen ; këtu ndahet për vdekje vet djalli nga djalli...Këto trishtime të trishta Dheu, këto pengje të kujtesës sonë kolektive, autorja, herë si femër, herë si motër, herë si nënë, herë si bijë, herë si gjëmë, i përcjell vendosmërisht, ndërgjegjeve të të gjithë botës, mesazhin e Femrave Shqiptare, mesazhin e Nënave Shqiptare, jo me fjalë, jo me lutje, por me klithma, me trishtim!..

Vargu i emrave, vargu i ngjarjeve, vargu i klithmave të fëmijëve, vargu i çmendjeve karpatjane, vargu i bishave të pasoj, vargu i popave të skëterrës, këngët e gjuhëve të gjarpërinjëve, përzihen në kore kohësh, përzihen në vargje dhimbjesh e përsëritjesh historish, që veç Zoti mund t`i shënojë në Ditarin Qiellor të Ndëshkimeve...

Se dhimbja s`është vetëm dhimbje, se dhimbja është qesharake përpara klithmave të dheut, autorja e shpreh me guxim femre, me guxim nëne të nëpërkëmbur nga doke e zakone mjegujsh, nga ligje e kode kanunesh; autorja e shpreh triumfshëm, kur trungut të quajtur ,,burrë" ja derdh pështymën në fytyrë...

Heroinat që mbajtën gjallë, herë me bukë, herë me lotë, damarët e lashtë të Dheut, të kombit, të fesë, të Atdheut, përbuzen sot çndershmërisht nga qenie të çnderuara nga vet qenia e tyre...Si të kuptojmë një viktimë, të çarmatosur e të coptuar nën dhëmbët e një hijene, një viktimë që turpërohet nga vet nderi i saj, nga vet dhimbjet e saj, përballë një qenieje monstruoze që veten e quan,,burrë"...

Jo Nëna, jo motra, jo bija të Dheut tim, jeni Nëna, jeni motra, jeni Nderi i Atdheut, jeni jeta e Atdheut, jeni historia e Tij...Ballin lartë të shkilni pragjet,

ballin lartë të shkilni fushat, malet, udhët...të shkilni mbi ato qenie që i shkelët gjer në vdekje. Le të skuqen historitë, le të skuqen ato qenie që s`kanë kapilarë skuqjeje, që s`kanë zemra nën lëkurë; le të skuqen zvarranikët, të jashtëm dhe të shtëpisë, që ju lanë në prag të derës, që frikë s`e patën turpin, as Zotin dhe as Atdheun...

Nganjëherë, vet higjiena e fjalës të cakton kufijt e të shprehurit, të pengon të futesh në ato kafazë misteresh të çmendjeve njerëzore, të gjejshë mjete e metoda për të vendosur paralele të çelikta përballë një shpërfytyrimi të monstrumeve të mbetur nga shkretëtirat e Sodomës...

Nuk e kam guximin tënd, autore e guximshme, nuk e kam fuqinë e fjalës së një femre, të një Nëne! S`marr në gojë dot asnjë emër, ndjehem fajtor, ndjehem ,,burrë"!..

Po di të lexoj shpirtin tënd, di të lexoj alfabetin ku jam edhe unë një shkronjë...Jam edhe unë një ,,vëzhgues", jam sy nëne, sy fëmije, jam sy gruaje...

Ndaj të lexoj dhe të uroj për këtë MONUMENT TRISHTIMI...

Lebit Murtishi 13.11.13 Bern ...

* * *

Vështrimi për librin e Luljeta Selimit

DHUNIMI I FEMRAVE GJATË LUFTËS NË KOSOVË - KRIM I PANDËSHKUAR!



Sheradin Berisha

Të nderuar zonja dhe zotrinj,

Nga të dhënat biografike për autoren e librit "Rrëfime tronditëse - femrat e dhunuara gjatë luftës së Kosovës", Luljeta Selimi - mësuam se ajo është një intelektuale e formuar profesionalisht në disa fusha, si: në gazetari, në letërsi, në mjekësi, në psikiatri etj., dhe të gjitha këto fusha duket se i ka sublimuar (i ka gërshetuar) me kohë në aktivitetin e saj humanitar, si

drejtoreshë e Organizatës Humanitare-Jo'qeveritare "Jeta në Kastriot", e cila ndihmon femrat e dhunuara seksualisht gjatë luftës në Kosovë (1998-1999), përkujdesen për fëmijët e tyre, si dhe ju ofrohet trajtimi i nevojshëm mjekësor për rehabilitim të plotë në shoqërinë tonë.

Libri i Luljeta Selimit "Rrëfime tronditëse - femrat e dhunuara gjatë luftës së Kosovës" ka 70 faqe, dhe përfshinë 20 rrëfime tronditëse të dëshmitareve që kanë përjetuar dhunën seksuale, gjatë luftës në Kosovë, dhe duket se kjo dhunë me përmasa mizore ishte planifikuar mjaftë mirë nga regjimi pushtues serbë!

Fillimisht dua të bëjë një parantezë!

Ashtu sikurse në ekonomi që çdo ecuri zhvillimore planifikohet paraprakisht, edhe në politikë shkaktimi i ngjarjeve dhe krizave të ndryshme planifikohen, nuk ndodhin aksidentalisht, pra nuk zhvillohen spontanisht. Presidenti i 32'të i SHBA've Franklin D.Roosvelt (30 janar 1882 - 12 prill 1945) ka një thënie epokale. Ai thotë (po citoi): "Në politikë asgjë nuk ndodh aksidentalisht! Në qoftëse diçka ndodh duhet të jeni të sigurt se ajo është planifikuar në atë mënyrë". Prandaj, krimet në masë, vrasja e shqiptarëve të paarmatosur, pleqë, gra e fëmijë, plaçkitja e pasurisë, djegjja dhe shkatërrimi i vendbanimeve, dhunimet e femrave shqiptare, spastrimi etnik dhe shpërgulja e popullatës shqiptare nga Kosova (1998-1999) nuk ishin vepra aksidentale - spontane, por të organizuar e palnifikuar mirë që të ndodhin në atë mënyrë siç kanë ndodhur. Pra, krimet dhe gjenocidi në Kosovë u krye në emër të një politike, të një plani kolektiv shtetëror, të cilin Shtabi kriminal i Millosheviqit e kishte emërtuar "Potkovica" - Plani "PATKOI". Në realizimin e këtij plani famëkeq Serbia si shtet mobilizoi të gjitha resurset njerëzore dhe teknologjike, administratën shtetërore, transportin publik, mjetet financiare, mediat, gjyqësinë, dhe mbi të gjitha strukturën e gjerë ushtarake - policore e paramilitare, duke filluar nga Korpusi ushtarak i Prishtinës, që përbënte superstrukturën e Armatës së tretë serbe në Kosovë, Korpusin 21 të Nishit, Korpusin 37 të Uzhicës, Korpusin 24 të Kragujevcit, Korpusin special dhe armatën e parë të Beogradit, Korpusin 2 të Podgoricës, strukturat e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, si: policia e rregullt e Kosovës,

Forcat speciale të policisë, Forcat e ashtuquajtura antiterroriste, Shërbimi i Sigurimit serbë (UDB-a), njësitë paramilitare, "Shkorpionët", "Tigrat e Arkanit", "Beli Orlovi" (Shqiponjat e Bardha) të Voisllav Sheshelit, "Beretat e Kuqe", njësitë kriminale të serbëve lokalë etj.

* * *

E bëra këtë parantezë, për të shpërfaqur faktin, se në dhunimin e dëshmitareve që rrëfejnë në këtë libër, kanë marrë pjesë: policë, kryepolicë, ushtarë, ushtarakë madje edhe me gradën gjeneral, si dhe paramilitarë të shumtë… Këto forca kriminale dhunimet i kanë kryer individualisht dhe në mënyrë grupore, nëpër shtëpi, në ambiente të shkollave, (si në fakultetin juridik në Prishtinë, në shkollën fillore "Naim Frashëri", në lagjen "Arbëria" të këtij qyteti), në male, në rrugë, në strehimore të improvizuara etj., dhe në shumicën e rasteve këto akte kriminale janë bërë në prezencën e prindërve, të vëllezërve, të bashkëshortëve të fëmijëve dhe të afërmve të tyre. Mosha e femrave të dhunuara sillej nga 13-14 deri në 44-45 vjeç. Gjatë dhunimit seksual, këto bisha me pamje njeriu, për ta nënshtruar viktimën, përveç dhunës fizike, kanë përdorur kondakun e pushkës, thika, dana elektrik, litarë, cigare dhe mjete tjera të forta, me të cilat atyre ju kanë shkaktuar plagë të rënda trupore dhe shpirtërore, ndërsa një numër prej tyre edhe kanë vdekur!

Se dhuna seksuale ka lënë pasoja të rënda, dhe ishte si të thuash "vrasje" fizike dhe shpirtërore për femrat e dhunuara, autorja e librit ka arritur ta argumentoj bindshëm, gjatë përshkrimit të gjendjes emocionale të dëshmitareve, derisa po rrëfenin për ngjarjen e ndodhur.

* * *

Luljeta Selimi, kontaktet e para me dëshmitaret e dhunuara i ka bërë, derisa po raportonte si gazetare nga zonat e luftës. Vetëm gjatë luftës, ajo bashkë me personelin e organizatës "Jeta në Kastriot", ka kryer 112 lindje në vendstrehimet malore, dhe prej tyre 109 fëmijë kanë mbijetuar dhe sot janë shëndosh e mirë, ndërkaq 3 fëmijë kanë vdekur, dy nga të ftohtit ndërsa një nga ngrënja e gjarpërit.

Ajo në libër shkruan, se OJQ "Jeta në Kastriot", kanë evidentuar 2018 femra të dhunuara, për të cilat përveç dëshmive gojore, me shkrim dhe fotografive të shumta, kanë videoxhirime, dhe raporte të mjekëve: gjinekologë, infektologë, neoropsikiatër, për gjendjen e tyre shëndetësore dhe trajtimin përkatës për secilën paciente veç e veç.

Nga kjo shifër e evidentuar, 114 femra janë në gjendje të rëndë psiko'fizike, sepse "kanë plagë të dukshme në trup, kanë gjinjë të prerë dhe prerje të ndryshme në pjesë tjera të trupit, kanë djegje me cigare, gishtrinj të këputur, 9 prej tyre kanë nga një sy të verbuar ose të dëmtuar pjesërisht, 37 veta tjera kanë plagë të hapura në fytyrë, ndërsa 3 femra kanë bërë vetëvrasje! Ndërkaq 386 gra janë të braktisura nga burrat, për shkak të dhunimit nga forcat kriminale serbe! (Burimi: Kërkesa publike (mars 2008) për ndihmë nga OJQ "Jeta në Kastriot", pashtriku.org)

Të nderuar vëllezër e motra,

Duket se e vërteta për dhunimet e femrave gjatë luftës në Kosovë, është margjinalizuar, dhe ka mbetur nën hije - siç thotë Luljeta Selimi në libër, nga njerëzit e rëndomtë e deri te pushtetarët tanë, por edhe nga vetë ndërkombëtarët që veprojnë në Kosovë. Ata sillen sikur këtu nuk ka ndodhur as luftë, as vrasje, as djegie e plaçkitje as dhunime, as asgjë prej gjëje. Ose edhe më keq, sillen sikur dhunimet kanë ndodhur diku tjetër, e jo këtu, para syve tanë dhe të botës!!!

Autorja nuk do t'i kishte botuar, këto rrëfime - sikur të mos dominonte kjo harresë kolektive, e mbi të gjitha sikur një ditë të mos i thoshte një e dhunuar, se ato "përveç se janë të dhunura janë edhe të braktisura dhe të fyera." "Ne që jemi dhunuar dhe sot vuajmë jemi morali dhe pamorali i të gjithë kosovarëve! Edhe kur jemi në mesin e të gjallëve, ne, sërish ndjehemi te vdekura! Edhe kur ecim rrugës, e ndjejmë peshën e dhunimit, e shohim atë në sytë e njerëzve, të cilët, ndoshta, kurrë nuk do të mund ta imagjinojnë së çfarë kemi përjetuar. Ne jemi plaga e çdo njeriu, vuajtja dhe mungesa e çdo fëmiu. Edhe kur njerëzit qeshin, pa kujtuar fare së ne ekzistojmë, ne mendojmë së ata qeshin dhe tallën me tragjedinë tonë. Edhe kur lotojnë,

shajnë e pështyjnë edhe atëherë ne jemi pjesa më e dhëmbëshme dhe më tragjike… Ne sot jemi të braktisura, dhe pesha e çdo gjëje që po ndërtohet në Kosovë rëndon mbi ne! Ne jemi gjaku, pluhuri dhe pështyma e djeshme e sotme dhe e nesërme e Kosovës, andaj dikush duhet ta ngre zërin për ne. Po ta them, ngase ti mund ta bësh këtë, sepse ti çdo ditë mjekon plagët tona. Dhëmbja jonë do të ishte akoma më e madhe po ta bënte dikush për tallje apo përfitime…" - i ka thënë ajo, Luljeta Selimit.

* * *

Zonja dhe zotrinj,

Luljeta Selimi përmes rrëfimit të dëshmitareve vë në dukje edhe disa virtyte e karakteristika të gruas dhe të burrit gjatë ngjarjeve të përjetuara. Spikatë njëkohësisht guximin dhe vendosmërinë e gruas, si dhe sinqeritetin, qyqarllëkun dhe karakterin e burrit.

Me këtë rast po i referohem vetëm katër dëshmitareve të këtij libri:

1. Guximi dhe vendosmëria e mjekes së Re për t'ia shpëtuar jetën vajzës së dhunuar!

Në një spital ushtarak të UÇK-së sillet një vajze (H.N) e dhunuar nga forcat kriminale serbe, e cila ishte në gjendje të rëndë shndetësore. Mjekët ushtarakë edhepse i kishin dhënë gjak, jeta e saj ishte në rrezikë, sepse gjaku nga plagët vazhdonte t'i rridhte pa ndërprerë. Ata donin t'ia shpëtonin jetën me çdo kusht dhe ftuan një mjeke femër nga një zonë tjetër e luftës. Me këtë rast ka adhur një mjeke e Re, e cila edhe pse ishte gjinekologe e padiplomuar, vendosi të kryej një ndërhyrje kirurgjikale në pjesën gjenitale të vajzës së dhunuar. Ndërkohë një mjeke tjetër, (gjinekologe e diplomuar), kur i pa plagët e vajzës, mjekes së re i drejtohet me fjalët: "mos e mundo, lëre të vdes. E sheh se kanë filluar t'i dalin organet jashtë, unë nuk do t'i hyja një pune të tillë". Mjekja e re, edhe pse e shqetësuar, ishte e vendosur t'ia shpëtonte jetën vajzës së dhunuar. Ajo ia kthen me shpejtësi: "Do t'më ndihmosh apo jo"… "Unë mendoj se është rrezik, ajo mund të vdesë",... Mjekja e Re pa humbur kohë ka filluar intervenimin kirurgjik, dhe nuk është

ndalur edhe atëherë kur kishin filluar granatimet serbe në afërsi të spitalit. Ajo me guxim të pashoqe përfundoi operimin me sukses. Edhe pas operacionit mjekja e Re nuk doli nga dhoma, vajzës ia pastroj edhe plagët në pjesë tjera të trupit dhe kështu ia shpetoj jetën. (Luljeta Selimi - Rrëfime tronditëse, femrat e dhunuara gjatë luftës në Kosovë, faqe 14 - 15)

2. Qyqarllëku një burracaku, i cili akzuon gruan për dhunimin që ia bënë forcat serbe, derisa ai ishte fshehur në kotec të pulave

Dëshmitarja R.R., nga një fshat i Therandës, kishte burrin një vajzë (Norën) 13 vjeçe dhe djalin 9 vjeçar. Vajzën, pasi ishte plagosur një ditë nga forcat serbe, derisa po merrte dru në malë, e kishin larguar jashtë Kosovës për shërim. Ajo kishte mbetur në shtëpi vetëm me burrin dhe djalin. Burri i saj nuk e ndihmonte fare gruan dhe kishte ditë që nuk dilte nga shtëpia, madje edhe atë ditë kur u rrethuan nga forcat kriminale serbe, dëshimtarja R.R (gruaja e tij) e kishte lutur që të largoheshin sa më parë nga shtëpia (pët t'i shpëtuar më të keqes), por ai e ka kundërshtuar duke i thënë se: "Unë e djali do të mbesim këtu...". Kur forcat serbe po futeshin në shtëpi ky burrec ka lënë gruan dhe djalin në dhomë dhe me shpejtësi është fshehur në kotec të pulave. Policia serbe hynë brenda, marrin R.R dhe djalin dhe i nxjerrin në oborr. Derisa po kontrollonin në shtëpi, kriminelët i thonë dëshmitares: "Ku e ke burrin? Nëse nuk na jep para dhe ar, do të ta vrasim djalin." Ajo është përpjekur të gjej pak para e ari, për ta shpëtuar djalin, por burri i kishte marrë të gjitha me vete, edhe paratë edhe arin. Derisa policët e kërcënonin me fjalët "O arin, o djalin" burri nga koteci i pulave e shikonte në heshtje këtë ngjarje, nuk bënte zë, "e donte shpirtin e vet më shumë se djalin" - thotë dëshmitarja R.R. Në këtë situatë të rëndë, një policë i pashpirtë me tri të shtëna nga revolja ia vretë djalin, ndërsa dëshmitares ia lidhin durat prapa dhe e dhunojnë derisa ajo e ka humbur vetëdijen. Krejt këtë ngjarje e ka shikuar heshturazi nga koteci, burri i saj. Pas kësaj ngjarjeje të dhimbshme R.R e ndihmojnë disa banorë të një fshati tjetër aty afër dhe ia mjekojnë plagët e shkatuar me thika, ndërsa gjatë kohës së bombardimeve për atë kujdesen vëllai dhe nusja e tij. Katër ditë pas përfundimit të luftës burri i R.R,

kthehet në shtëpi dhe në prani të vëllaut të saj, atë e fajson për dhunimin që ia bënë forcat serbe!

Burri i thotë: "Më mirë të kishe vdekur, tani je pa fëmijë dhe pa burrë, është dashur ta vrasësh veten, je fajtore që të dhunuan serbët", ndërsa R.R me lotë në sy i thotë: "Unë fajtore! Ngase ti i more paratë dhe nuk ua dhe barbarëve ta shpëtosh djalin tënd, unë fajtore që ti nuk na le të dalim nga fshati edhe atëherë kur të gjithë e shifnim rrezikun"!

"Motrën tënde e dhunuan ushtarët serbë dhe unë s'mund ta kem më grua! - i thotë ai vëllait të R.R dhe largohet për të mos u kthyer kurrë më familje. Ky është karakteri i një burracaku! (Faqe 21 - 23)

3. Karakteri burrëror, (burri që pranon fajin dhe turpin për atë që i kishte ndodhur gruas së tij)

Dëshmitarja B.B. nga Gjakova nënë e 6 vajzave dhe një djali 12 vjeçar, pas bombardimeve të NATO-s, bashkë me burrin dhe fëmijët si dhe katër familje tjera strehohen në shtëpinë e një miku në dalje të Gjakovës. Në një mengjes herët Policia e kishte thyer derën, ku ishin strehuar dhe janë futur brenda. Pasi i kanë plaçkitur të gjitha gjësendet me vlerë, janë përpjekur t'i ndajnë burrat nga gratë… dëshmitarja ka kundërshuar, ndërkohë që një djalë i cili ishte strehuar aty vritet gjatë kohës që po provonte të largohej, me këtë rast vdes edhe nëna e tij nga plagët e marra gjatë tentimit për ta mbrojtur djalin nga vrasja!

Barbarët serbë, të revoltuar, nga ky kundërshtim i lidhin të gjithë meshkujt, ndërsa gratë dhe vajzat i zhveshin dhe i dhunojnë në prani të burrave dhe fëmijëve të tyre. Dhe të gjitha këto skena mizore, kriminelët i kanë filmuar me Kamerë. Dëshmitarja fillimisht rrëfen, se si e kanë dhunuar tre vetë, vajzën 15 vjeçare, e cila pas gjysëm orë vdesë nga kjo dhunë shtazarake, pastaj për një femër tjetër të re, e cila derisa po klithte për ndihmë, ia hiqnin edhe thonjtë e gishtave! Ndërkaq për vete thotë se gjatë dhunimit ia kanë prerë edhe gjirin!

Pas kësaj ngjarjeje makabre, gratë i lëna të lirë, ndërsa mashkujt i marrin me vete. Burrin ia burgosin dhe katër muaj pas përfundimit të luftës lirohet, ndërsa për djalin12 vjeçar nuk di asgjë, edhe sot e kësaj dite.

Kur është kthyer burri nga burgu, B.B, duke u ndjerë e turpëruar për dhunimin që ia kanë bërë forcat kriminale serbe në prani të tij, ka kërkuar që të kthehet në familjen e saj (në gjini), por burri me lotë në sy, i thotë: "Jo grua, ti nuk do të shkosh askund, ti je nderi i familjes, dhe nëse dikush është i turpëruar në këtë shtëpi, atëherë ai jam unë. Nderin e familjes është dashur ta mbrojë unë e jo ti. Ti je e pafajshme, ti ishe dhe je gruaja ime. Ti do të jeshë mburrja dhe krenaria ime, sepse ti nuk deshe të ikësh pa mua, dhe unë, bashkë me të gjithë ata burra të tjerë të Kosovës, që nuk e morëm pushkën, jemi të turpëruar, e jo ju, nënat që Kosovës ditët t'i falni dhe t'i lindni djemë që ditën dhe guxuan t'i dalin zot Kosovës"! Sot dëshmitarja B.B, jeton bashkë me burrin dhe vajzat, me shpresë se do t'i kthehet një ditë edhe djali i tyre vetëm. (faqe 29 - 31)

4. Një familje intelektuale nga Prishtina që e kishte përjetuar luftën nga televizioni…

Dëshmitarja H.G një intelektuale nga Prishtina, vetëm pas 24 marsit 1999 kur nisën bombardimet e NATO-s, dhe kishin filluar forcat ushtarake-policore dhe paramilitare t'i nxjerrnin me dhunë shqiptarët nga shtëpitë e tyre në Prishinë, kishte besuar në vatrat e luftës që ishin ndezur gjithandej Kosovës, deri atëherë ajo dhe burri i saj luftën e kishin parë e përjetuar vetëm nga ekrani i televizionit! Kjo ishte e vërtet, sepse gjatë vitit 1998 kur lufta e përgjakshme kishte kapluar shumë qytete dhe fshatra të Kosovës - në Prishtinë, zhvillohej një jetë "normale", njerëzit shetisnin të qetë mbrëmjeve - në sheshin Nënë Tereza, bënin ahegje të ndryshme, punonin klubet e natës dhe lufta përjetohej sikur të ndodhte diku tjetër, e jo në Kosovë!

Dëshmitarja H.G gjatë rrëfimit pa hamendje thotë se si "intelektuale isha lidhur ngushtë me ata që ishin kundër luftës sepse ishim mësuar që të tjerët të vriten në demonstrata, të tjerët të dalin në protesta, të tjerët të vuajnë e shpresonim se do të mund të fitonim në kurriz të të tjerëve!" Ndërkaq, H.G's

i kujtohen mirë fjalët e burrit, në momentin kur po e merrnin kriminelët nga shtëpia për të mos u kthyr kurrë më. Ai ka mallkuar vetën që nuk kishte shkuar t'i bashkohej UÇK-së, dhe derisa po futej në veturën e kriminelëve, gruas dhe vajzës me zërin gjithë vaj u ka thënë: "Nuk e meritoj as të qahem sepse unë nuk po vdes si trim, si trimat me pushkë në dorë, por si një qyqar, si një i marrë që nuk e përkrahu luftën Çlirimtare të popullit të vet".

Ndërkohë që i kishin përzënë të gjitha familjet e lagjes, njësitë kriminale serbe të gjithë mashkujt i morën, ndërsa 20 femra (gra e vajza) bashkë me to edhe dëshmitaren H.G dhe vajzën e saj, i kanë dërguar në shkollën fillore "Naim Frashëri". "Dy që ishin mbi 40 vjet i vranë menjëherë! E vranë poashtu edhe një plak tjetër" - thotë dëshmitarja H.G. Ajo pastaj gjerësisht ka rrëfyer për aktet e tmerrshme e mizore të dhunimit seksual që kanë kryen forcat ushtarake serbe në ambientet e shkollës, ndaj saj, ndaj vajzës dhe femrave të tjera… (faqe 34 - 36)

Të nderuar vëllezër e motra,

Ne edhe pas 14 vjetësh nga përfundimi i luftës, nuk e dimë numrin e saktë, të nënave e motrave tona të dhunuara mizorisht nga forcat kriminale serbe. Është shkruar shumë herë në mediet tona, se gjatë luftës në Kosovë (1998-1999), forcat militare dhe paramilitare serbe kanë përdhunuar 20 mijë femra shqiptare, por askush deri më sot nuk e ka vërtetuar këtë shifër kaq të lartë, madje as vetë organizatat e huaja të cilat kanë bërë hulumtime të shumta në këtë drejtim.

Është i habitshëm edhe një fakt tjetër, (kur flasim për numra)!

Ne ende nuk e dimë as numrin e saktë të njerëzve të vrarë e masakruar gjatë luftës në Kosovë (1998-1999). Në shumë prezentime të politikanëve, historianëve, publicistëve, analistëve, të shoqatave për të drejtat e njeriut etj., përmenden shifra të ndryshme. Thuhet se gjatë luftës në Kosovë janë vrarë: - 10 000, - 12 000, - 13 000 apo - 15 000 shqiptarë! Kjo shpërfaqje (shumësi) e shifrave tregon se, sa të papërgjegjshëm jemi si shtet dhe shoqëri, ndaj njerëzve tanë që u flijuan për këtë vend!

* * *

Në librin e Luljeta Selimit, dëshmitaret përmendin edhe emra të krimielëve që kryen dhunimin, siç janë: Dragan Spasiq, Nenad Stojanoviq, gjeneral Vujiq, dhe për fat të keq edhe pse dihen tashmë emrat e tyre, (dhe të qindra kriminelëve të tjerë), deri më sot askush nga përgjegjësit e sigurisë në Kosovë, as policia apo prokuroria e UNNMIK'ut as këta të EULEX'it, por as policia e Kosovës apo prokuroria vendore, madje as institucionet tjera ndërkombëtare apo ato vendore (Qeveria, presidenca, Kuvendi apo shoqëria civile), nuk kanë treguar gatishmëri, për t´i ndjekur e arrestuar këta kriminelë.

Për çudi as Tribunali i Hagës, i cili aktet e dhunimit të femrave në Kosovë i specifikonte si krime kundër njerëzimit, shkelje të ligjeve të luftës, torturë, etj., asnjëherë nuk është interesuar t'i trajtoj në gjyq, dhe prandaj asnjë dëshmitare e dhunuar nuk ishte ftuar në gjykim për të dëshmuar kundër kriminelit Millosheviq dhe gjeneralëve të tij. Në mënyrë selektive janë trajtuar edhe krimet dhe gjenocidi, që kryen forcat ushtarako'policore e paramilitare serbe në mënyrë të planifikuar, kundër popullsisë shqiptare në Kosovë. Këtë fakt e ka pranuar edhe vetë Prokurori i kësaj gjykate Richard Goldston, i cili ka deklaruar se "për krimin e përdhunimit, komuniteti ndërkombëtar nuk ka qenë kurrë i interesuar"!

* * *

Për më tepër, ky tribunal as që është munduar ndonjëherë t'i ndjek kriminelët e organizuar në nivelet më të ulëta të sistemit shtetëror serb, që kryen krime dhe gjenocidë në Kosovë!

Për këtë fakt flasin hetuesit e OKB-së për krime të luftës.

Pas përfundimit të luftës në Kosovë, në një raport për masakrën e Qyshkut (14. 05. 1999), të publikuar nga Michael Montgomery dhe Stephen Smith, hetuesi i OKB-së për krime të luftës, Dennis Milner - ka theksuar (po citoi): "Puna e ekipit të tij do të vazhdojë të fokusohet thuaja tërësisht në rangun e lartë të regjimit të të kryeakuzuarit për krime lufte, kryetarit jugosllavë

Sllobodan Millosheviq". "Mund të thuhet se Tribunali (i Hagës - vërejtja ime) as që është themeluar ndonjëherë ose kurrë nuk ka pasur për qëllim të vihet pas gjykimit të akterëve të krimeve në nivelet e ulëta"… "Ne do të insistojmë", - thotë Milner - "në atë se ata në krye janë personat përgjegjës, dhe se ata, duke qenë të implikuar, kanë tërhequr këmbëzën.". Edhe M. Cherif Bassiouni, një tjetër hetues i OKB-së për krime lufte në Kosovë, mbështet fokusimin e Tribunalit të Hagës vetëm mbi Sllobodan Millosheviqin dhe bashkëpunëtorët e tij të lartë. Madje Z. Bassiouni, për çudi deklaron (po citoi): "Çështja themelore, nuk është në dënimin e krimeve të kaluara, por në parandalimin e krimeve të ardhshme"…!!! Ndërsa Florence Hartmann, Zëdhënëse dhe këshilltare e Prokorisë së Tribunalit të Hagës, nga tetori 2000 deri në tetor 2006, në librin e saj "Paqja dhe ndëshkimi", ka shkruar (po citoj): "Tribunali i Hagës (ICTY) pa dyshim më shumë se cilido gjyq tjetër ishte paramenduar t'i shërbente në rend të parë politikës, e jo drejtësisë" (Florence Hartmann: Paqja dhe ndëshkimi, Koha - mars 2011, f.30)

Dhe si përfundim!

Duke u bazuar në deklarimet e përgjegjësve ndërkombëtarë të hetuesisë, duket se vrasësit e mijëra shqiptarëve dhe dhunuesit e femrave shqiptare që përfshihen në librin e Luljeta Selimit, nuk do të dalin kurrë para drejtësisë, dhe se ky krim do të mbetet i pandëshkuar!

Ju faleminderit për vëmendjen tuaj.

Sheradin Berisha - Solothurn, 24. 11. 2013

* * *

Luljeta Selimi „Rrëfime tronditëse“



Hamzë Morina

Të ballafaqohesh drejtpërdrejtë me fatin e keq të një krimi makaber që kishte ndodhur në luftë - dhunim barbar dhe i egër, e të përpiqesh të kurosh jo vetëm plagët e trupit po edhe të shpirtit të shkatrruar të femrës shqiptare do të thot të posedosh kurajo të madhe për sa kohë që këto viktima po anashkaloheshin nga të gjithë, duke filluar nga familja e deri tek shteti që me gjasë nuk egzistonte ende. Luljeta Selimi me një energji të pashterrshme merr guxim për tu përballur me këto probleme që janë të pabërballueshme. Kështu e pashë unë Luljetën në takimin e parë me te dhe kjo bindje mu shtua pasi fillova të lexoj librin e saj „Rrëfime tronditëse“, një kronikë tmerri për dhunimet e femrës shqiptare gjatë luftës. U binda se guximi i saj për tu përballur me njërin nga sfidat më të rënda dhe më të dhimbshme të kohës së luftës ishte një dhunti që nuk e posedojnë të gjithë.

Ky libër mua më mori shumë kohë. Me volumin që kishte pretendoja se brenda një kohe të shkurtër do t i bija në fund, sepse kështu ndodh kur u përkushtohem librave që më tërheqin. Por ndodhi e kundërta, leximin e këtij libri e përfundova pas disa muajsh. Hetova se këto vite më kishin ligshtuar. Një ankth i tmerrshëm më pengonte të lexoja rrëfimet aq shumë sa më duhej të ndërprisja dhe të vazhdoja pas disa kohësh kur ky ankth fashitej. Ishte tmerri që përshkruhej në këto rrëfime të cilin shpirti nuk e duronte dhe një vlim i brendshëm më sillte në pozita të palakmueshme që më detyronte të ndërprisja. Kur miku im më propozoj që të bëja një shkrim për këto rrëfime, hezitova. Ishte droja e përseritjes së këtij ankthi. Ankth që buronte nga:

- dhimbja e shqetsimi i madh për këto viktima dhe për fatin e tyre në njëren anë, dhe

- harresa jonë e përkujdesja kurrfare e shoqërisë ndaj tyre, deri te përbuzja.

Autorja ka lindur në Prishtinë ku ka kryer dhe shkollen e mesme dhe studimet në Gjuhë, letërsi dhe gazetari si dhe shkollën e lartë mjeksore. Ka specializuar në Trier për Traumatologji dhe është pajisur

pas luftës me çertifikata të ndryshme për punën e saj të palodhshme në ndihmë viktimave të luftës e sidomos grave të dhunuara me shoqatën e grave „Jeta në Kastriot“ e cila me stafin e saj ka ndihmuar nënat e traumatizuara dhe fëmijët e tyre si pasojë e dhunimeve të luftës.

Libri tashmë është përkthyer edhe në gjuhët tjera dhe i referohet edhe një publiku më të gjërë.

Luljeta ka dhe botime tjera, libri i saj me poezi „Lindje pa emër“ dhe romanet „Tre muajt e Anites“, „Venitja“ e „Udhëkryqi“ përbëjnë opusin krijues që bashkë me librin që kemi përpara në shqyrim “ Rrëfime tronditëse“ përmbyllin një veprimtari të suksesshme në këtë fushë. Po veprimtaria e Luljetës është më e gjërë. Menagjimi me shoqatën, puna si gazetare dhe ajo në statistiken e Kosovës dëshmon për kreativitetin e saj në fusha të caktuara.

Po ajo që ne na intereson tash është puna me rrëfimet. Cili ka qenë qëllimi i saj me mbledhjen dhe publikimin e këtyre rrëfimeve. Shpresoj që

- Aspekti humanitar ta ketë shtyrë Luljetën në rend të parë të vijë në kontakt të parë me këto viktima, për të filluar ndihmën për lehtësimin e dhimbjeve trupore dhe shpirtërore përmes shoqatës së saj. Ky humanizëm fillon atëherë kur ishte më i nevojshëm si emergjencë gjatë luftës dhe pas saj, në terapinë e mëtejme për tu liruar nga traumat dhe për ta përballuar përbuzjen dhe mos përkujdesjen e një shoqërie kaotike të dalë nga lufta e egër.
- Shpalosja e së vërtetës për një kapitull të dhimbshëm të luftës që kjo e vërtetë të bëhej publike dhe të mos mbetej nën hije, që ky krim të mos heshtet dhe të zbulohet. Që ky krim të mos mbetet i pa ndëshkuar, sepse do të ishte vërtet një turp. Kur heshtja e tij më së shumti i favorizionte kriminelët të përballur me gjykatat ndërkombëtare. Heshtja jonë dhe anashkalimi para këtij krimi monstruoz do të ndihmonte amnestimin e këti krimi.
- Ndërgjegjësimi i opinionit për ndihmë kësaj kategorie – Të dhunuarat të mos mbesin pa ndihmën e nevojshme dhe të thyhet tabuja që mos të hezitohet që të dhunuarat ta paraqesin rastin e të mos luhet me kodin moral nga një pjese konsevatore. Viktimat të kurohen dhe për to të gjendet përkujdesja adekuate, pse jo edhe shtetërore(ligjore). Të mos abuzohet në emër të së drejtës për përkujdesje. Kjo kategori të mos

përbuzet sepse bëhet një dhunim i dytë ndaj tyre.

Të heshtësh do të thot baras me vrasje. Ajo që ka ndodhur me këto femra nuk ka ndodhur me fajin e tyre. Ajo ka qenë dhunë dhe çdo dhunë duhet të denoncohet e jo të fshihet çoftë ajo edhe në emër të një farë morali tradicional(që u dëgjua edhe në parlamentin tonë). Kjo mund ti ketë ndodhur gjithkujt në një luftë të pa barabartë me forca militare të shfrenuara dhe të përgatitura mirë për gjenocid ndaj një populli të pambrojtur.

A guxojmë të jemi indiferentë ndaj asaj që ka ndodhur. Indifenca është tallje për viktimat. Dhe nëse tallemi, vërtet a jemi aq të marrë sa të mos kuptojmë se me dhunimin e tyre jemi dhunuar edhe ne!? A nuk është fati i të dhunuarave në luftë edhe fati ynë kolektiv. Nëse nuk mund të hakmerremi, e këtë nuk mund ta bëjmë sepse nuk ishim të zotët ti mbrojmë atëherë kur duhej, a do të thotë që edhe sot ti lëmë pa përkujdesje ato që u sakrifikuan me trupin dhe shpirtin e tyre për të mbrojtur nderin dhe fëmijët e tyre, për të na mbrojtur edhe ne.

Rrëfimet e tilla të pasqyruara do të duhej të jenë një kambanë për ndergjegjen tonë, që qenjën tonë më të dhimbshme të dhunuar ta mbrojmë së paku sot kur kemi mundësi që të ngrejmë zërin dhe të kërkojmë drejtësi për to. Duke ofruar ndihmën adekuate dhe duke kërkuar drejtësinë për to ne do ta shfajsojmë veten pasi edhe ne jemi të dhunuar paçka se nuk e ndjemjmë dhimbjen, pa çka se nuk e përjetuam tragjedinë direkte, siç përjetuan ato me trupin dhe shpirtin e tyre.

Rrëfimet tronditëse janë një kronikë trishtuese. Po kjo nuk habit kur vie nga një armik i përbetuar shekullor që qëllim parësor i ka vënë vetes zhdukjen e racës shqiptare. Kujto elaboratet shfarosëse të Akademisë serbe në të gjitha kohet dhe punën e të gjitha qeverive që pasuan kundrejt qenjes sonë. Mjafton të kujtosh pastaj propaganden e shtypit serb para lufte për rolin e gruas shqiptare e cila me lindjet dhe plleshmërinë kishte penguar të gjitha këto elaborate. Ate në mënyren më barbare po e cilsonin si lavatriqe. Domosdo krejt kjo shfryrje në luftë kishte për pasojë rolin e madh të nënës shqiptare në mbijetesen në këto troje. A nuk ishte kujdesi i femrës gjatë historisë që të kompenzojë dëmet

e termeteve, epidemive e luftrave të shumta me plleshmërinë e saj. Prandaj barbarët shfrytzuan këtë luftë të egër që të shkatrrojnë burimin e jetës gruan shqiptare duke e damkosur fizikisht e moralisht – qëllim që nuk e arriten anipse sakatosen me qindra e mijëra nëna duke na lënë të traumatizuar. Ky shfrenim i makinerisë ushtarake e policore serbe shfryu inatin dhe epshet shtazarake në mënyren ma barbare duke shfaqur pezmin shekullor mbi qenjen më të brishtë që kishte krijuar natyra ndoshta mu pse kishin deshtuar të gjitha elaboratet e përgatitura.

Rrëfimet tronditëse dëshmojnë për mënyrat më makabre:

- Për nga hapsira se ku ndodhën asnjë krahinë në kosovë nuk ishte kursyer
- Për nga mosha nuk ka pasur përjashtim nga të miturat deri te plakat e moshura
- Objektet që kanë shërbyer kanë qenë duke filluar nga shtëpite e viktimave, kampet e deri te dhunimet e hapura publike në natyrë.

Qëllimi ishte i çartë:

- dhunimet si mjet lufte me karakter poshtërues, politik dhe hakmarrës në rend të parë
- si thyerje morale dhe shpirtërore te popullit shqiptar me format me mizore dhunim dhe vrasje, dhunim para syve të familjarëve, poshtërim gjatë dhunimit dhe format tjera më bizare duke shfryrë sadizmin më ekstrem.

Krejt këtë dhunë seksuale ata e përdorën për të shkatrruar qenjen fizike dhe shpirtërore të femrës shqiptare duke atakuar jo vetëm aspektin moral të gjinisë më të ndieshme po duke sulmuar edhe mbi integritetin moral kombëtar. Pra duke dhunuar nënat, motrat e vajzat tona ata dhunuan qenjen tonë kombëtare-shtyllë e së cilës ishin ato.

Tërë kjo kaloj pa ndëshkim, dhe ky është turpi ynë, anipse dhuna seksuale në luftë sanksionohet si cenimi më i rëndë i së drejtës njerzore sipas konventave ndërkombëtare. Ajo është forma më brutale gjenocidale për të cilën Serbia jo vetëm që s mori denim por kaloj e përkrahur në të gjithë luftërat e ish Jugosllavisë nga aleatë të caktuar që kishin interesa gjeopolitike në Ballkan. Ky libër ndërgjegjson opinionin se gjërat që harrohen mund të përseriten.

Hamzë Morina, Solothurn - 24. 11. 2013

* * *

Tragjedi me dhembje që vazhdojnë

Gani Qarri

Tubimet si ky i sotmi në nderim të përvjetorëve kaq të rëndësishëm për kombin dhe atdheun, përveç krenarisë së luftës dhe fitoreve, na kujtojnë edhe vuajtjet e përjetuara si dhe sakrificat e kaluara nën pushtuesit e shumtë që shkelën këto troje, për të arritur deri këtu ku jemi.

Por,nga të gjitha sakrificat e kaluara, për fatkeqësinë e shqiptarëve, gjenocidi serb,dallohej për të keq nga gjithë të tjerët, ngase ai nuk kurseu moshë as gjini,përfshi edhe gratë e fëmijët që padyshim,në të gjitha kohët ishin kategoria më e vuajtur e popullit shqiptar.

Ndaj,me siguri,do të shkojnë vite e dekada e ndoshta do kalojnë edhe shekuj,e megjithatë, jo vetëm plagët fizike,por më tepër ato shpirtërore dhe psikike, bashkë me vrasjen e ndjenjave njerëzore të viktimave, nuk do të plaken as harrohen kurrë në trojet tona.

Për vuajtje e sakrifica,deri më tani mund të jenë shkruar shumë libra nga autor të ndryshëm,por një me përmbajtje më tjetër dhe përjetime më tepër se rrënqethëse gjatë një lufte, ngjashëm me tregimet e ferrit,ka shkruar Luljeta Selimi, i cili jo vetëm se përshkohet nga ngjarje shumë trishtuese por mban edhe titullin mjaft prekës që përkon me përmbajtjen e librit të titulluar; "Tregime tmerruese".

Megjithatë ne për vite të tëra, sikur jemi mësuar që të flasim vetëm për historitë e dëshmorëve dhe trimëritë e heronjve gjë që është për tu admiruar,por në anën tjetër nuk duhet harruar se veprat gjenocidiale serbe nuk kursyen askënd. Ato para së gjithash ushtruan gjenocid të organizuar shtetëror kudo në Kosovë dhe nuk kursyen moshë as gjini,në të gjitha trojet tona.

Në mënyrë të veçantë duhet theksuar gjenocidi dhe mizoria serbe e ushtruar ndaj femrës së pambrojtur shqiptare, gjë që për shumë vite u hesht fare,dhe

deri më tani u trajtua gati si temë-tabu,sado që kjo plagë ishte dhe mbeti njëra prej dhembjeve më të rënda, nga të gjitha vuajtjet e përjetuara gjatë dhe pas luftës së fundit në Kosovë.
Për të mësuar më shumë mbi përmasat e këtij krimi, për dhembjet, plagët dhe vdekjet e tyre,duhet lexuar libri "**Rrëfime tronditëse**"me përjetimet më monstruoze dhe trishtuese ndaj mijëra sosh,në të kaluarën e hidhur jo të largët të vendit tonë, nga pushtuesit serb.
Ndaj,për një libër si ky,nuk ishte aq e lehtë të marrësh përsipër përgatitjen e një vështrim racional, dhe të flitet për ngjarje kaq të rënda të një pjese jo të vogël të qenies sonë kombëtare, të cilat,nën orgjinë e dhunës së organizuar të pushtuesve serb,kaluan rrugë dhe destinacione ferri me vuajtjet më të rënda të mundshme,deri në pakufi, të cilat kurrë nuk mund ti kishin paramenduar ndonjëherë në jetën e tyre.
Për mes leximit të këtij libri, që nga fillimi deri në fund...njeriu pa dashje rijeton edhe njëherë kohën e rëndë të luftës së rishfaqur nëpër fletët e "Rrëfimeve tmerruese",kur gjatë udhëtimit nëpër raste dhe ngjarje,sytë e secilit lexues shpesh herë mund të lagen nga lotët e dhembjes për vuajtjet e papërshkrueshme të këtyre viktimave.
Megjithatë,që nga koha e kësaj çmendurie antinjerëzore, ato asnjëherë nuk gëzuan vëmendjen e duhur të opinionit dhe organeve përkatëse shtetërore. Ndaj,lidhur me këto fatkeqësi,autorja që në parathënie konstaton se"Dhunimet janë të rënda për çdo Popull në botë, veçanërisht për popullin tonë,për të cilin morali ishte pjesa më e ndjeshme e qenies së tij"
Ngjarjet e tilla, me gjithë mundin dhe përpjekjet, sot është e vështirë të përshkruhen të gjitha deri në detaje mbi letrën e bardhë, ashtu siç edhe kanë ndodhë, ngase secili përjetim është më i rëndë se tjetri, prej të cilëve barbarët,nuk kursyen as fëmijët dhe vajzat e moshës minore.
Për shembull në rrëfimin e 13, mes tjerash thuhet.
papritmas dhe pa trokitur fare,na u thye dera dhe në dhomë na u futën ushtar e policë serb....Nerës e cila ishte vetëm 14 vjeçare.....njëri filloi ta ledhatonte... ajo ia shtyu dorën.... ai i ra me ..... sa pati fuqi.....ajo iku jashtë .....por dy nga policët ia lidhën duart....ai ia shqeu rrobat e shtriu në borë dhe filloi ta çnderonte.....
Në Kosovë,krimi serb ndaj shqiptarëve, nuk njohu fytyrë as gjini, përkundrazi ai vërshoi rrëmbyeshëm çdo gjë që gjeti para vetes, duke zgjedhur pikat më nevralgjike të kombit për lëndimin sa më çnjerëzor ndaj një Populli të tërë, të cilin jo vetëm se donte ta mundte e shfaroste por edhe ta poshtëronte në të gjitha mënyrat.

Sipas rrëfimeve autentike, të mbledhura nga autorja Selimi, vërtetohet se ushtria dhe policia kriminele serbe ,përveç përdhunimeve sistematike në ambiente të hapura, para syve të familjarëve, prindërve, burrave,vëllezërve dhe fëmijëve,ata kishin hapur edhe kampe të veçanta përdhunimi ku bënin edhe terrorizim e masakrime,vizatime simbolesh serbe me thika- mbi lëkurën e njomë të femrave shqiptare, deri në copëtimin fizik të trupave të tyre, siç shprehet edhe viktima me sinjalet S.S.

.... me 1 prill, ditën kur shqiptarët po dëboheshin masivisht më shkëputën nga familja, më futën në një dhomë,me një tavolinë të përgjakur.....
më përdhunuan disa ditë me radhë dhe më hodhën të zhveshur në rrugë, trupin ..... ma kishin prerë me thika në shumë vende dhe kishin vizatuar kryqe e simbole tjera serbe. Histori të denja për "Ferrin" këto.

Madje, që në parathënie, autorja e këtij libri sjellë bindjen e një viktime, e cila edhe sot ndihet si "Plaga e çdo njeriu"në të cilën rëndon pesha e çdo të keqe, që mundi të binte mbi Kosovë, ani pse autorët e krimit deklaronin hapur identitetin e tyre para viktimave,siç ceket edhe në këtë rrëfim, megjithëse deri më tani nuk mori dënimin meritor pothuajse askush nga këta kriminel.

*R.N.nga Prishtina...thot...Me cigaren e ndezur mu afrua, dhe më tha: "**Më quajnë Nenad Stojanoviq**... "Unë, do të ta lë një kujtim për tërë jetën, Do të të vras ngadalë.....",ma afroi cigaren te gjitë e mi dhe e fiku atje...më kanë dhunuar që të gjithë me radhë dhe ende sot, kam në trupin tim me qindra plagë cigaresh dhe plagë thike, ku kanë gdhendur turli fjalësh në serbisht".*

Për fat të keq,viktimat e tilla mbetën përherë pa shpresë e pa mbështetje dhe të vetmuarat më të mëdha të historisë së këtij fillimshekulli. Kurse për krimet ndaj tyre, deri më tani nuk u gjykua askush, sikur mos të mjaftonte fakti se kriminelët që vranë e prenë në Kosovë,tregonin emër e mbiemër dhe numrin e atyre të pafatëve që ata ua kishin marrë jetën me dorën e vet siç shpjegohet edhe në këtë citat:

*.....udhëheqësi i kriminelëve mu afrua dhe më tha, "Mua më quajnë **Dragan Spasiq**... jam njeriu që me dorën time kam prerë fytin e 50 shqiptarëve,*

Ndaj është shumë e vështirë vetëm të paramendohet e lëre më të besohet se si qindra e ndoshta mijëra gra dhe vajza të cilat u kidnapuan me forcë, përdhunuan dhe torturuan deri në vdekje nga pushtuesit barbar serb, dikush sot me një lëvizje dore, ato dhe krimin e përjetuar, dëshiron ti bëj të harruara dhe të paqena përgjithmonë,sikur të mos kishte ndodhur asgjë asnjëherë,derisa historitë e tyre përsëriten kaq rrënqethëshëm si në këtë citat:

R. R. nga një fshat i Therandës" në mbrëmje , plumbat na hynin në dhomë nga të gjithë anët,..... unë i thashë djalit të ikte e të shpëtonte por ai nuk ma lëshonte dorën. Policët na nxorën në oborr dhe kontrollonin për gjëra të vlefshme. Më thanë " arin dhe parat, ose do ta vrasim djalin". U përpoqa të gjeja por ishin pak,..... Një milic shtiu tri herë përmbi djalin tim të vetëm i cili dha shpirt duke parë tërë kohën nga unë që ta shpëtoja.....

Mjerisht, siç ceket në libër, pati edhe të burracak të tillë të cilët në momentet vendimtare, kur duhej të mbrohej gruaja dhe familja,për të shpëtuar veten, ata do të fshiheshin edhe nëpër kotece pulash, apo iknin nga mundnin duke i lënë gratë vetëm pa qenë në gjendje të reagojnë as kur u vriteshin fëmijët para syve të tyre nga përdhunuesit barbar sllav,kurse pas lufte po këto "burra" morën guximin dhe i dëbuan grat, me arsyetimin se ishin të përdhunuara nga ushtria dhe policia kriminele serbe.

Ndaj,nga shkaqe të tilla,shumë femra,nuk pranuan as mjekimin, e disa syresh bënë vetëvrasje duke u hedhur edhe në det të hapur, për të përfunduar jetën e tyre.

Siç e përmend edhe zonja Selimi, në Kanunin e Lekë Dukagjinit thuhet qartë se, në raste si këto, nuk lihet (nuk ndahet) gruaja, por, që të dy bashkë, duhet të hakmerren ndaj përdhunuesit apo grupit të përdhunueseve, megjithatë rrëfimet e viktimave tregojnë histori, në të cilat e keqja nuk njeh fund....., Citat:

Katër ditë pas përfundimit të luftës, vëllai..... që më dinte të vrarë erdhi bashkë me burrin tim dhe më tha: "Më mirë të kishë vdekur; tani je pa fëmijë dhe pa burrë, i cili iku për të mos u kthyer ".

Ndaj,përveç një numri të kufizuar femrash të cilat kishin marrë armët dhe shkuar në luftë për të mbrojtur atdheun dhe nderin e vendit, pjesa më e madhe e atyre që nuk pati kush ti mbronte dhe ranë në duart e kriminelëve serb,nuk guxuan kurrë të flisnin mbi përjetimet e tyre.

Në krime si këto,siç vijnë edhe lajmet më të reja, kohëve të fundit nga vet kriminelët pjesëmarrës në këto akte të rënda, nuk do të merrnin pjesë vetëm ushtar e polic të thjeshtë por edhe oficer të lartë të ushtrisë e policisë pushtuese serbe.

Madje,përmendet edhe emri i një gjenerali me emrin Vujiq,si pjesëmarrës përdhunimi në fshatin Smolicë afër Gjakovës,të cilin do ta shpjegonte në rrëfimin e 19, një vajzë e re nga Deçani,e cila kishte mundur ta lexonte emrin e përdhunuesit në uniformën e tij.

Megjithatë edhe pas gati 15 vitesh të kaluara,rrallë u shkrua dhe shumë pak u përmend fati keq i këtyre viktimave të cilat nuk bënë ndonjë mëkat për të

cilin ato do duhej të ndëshkoheshin apo kërkonin falje, përkundrazi përjetuan tragjedi nga të cilat shumë sish vdiqën,kurse ato që mbijetuan vuajnë edhe sot,nga traumat e përjetimeve të kaluara përmes laboratorit të përdhunimeve sllave si pjesa më e errët,nga gjithë historia e krimeve serbe të luftës së fundit në Kosovë.

Nga të rrallat, autorja Selimi,shkroi për të gjitha ato që nuk kishin zë të flisnin vet dhe ta thonin të vërtetën e hidhur, pasi që atyre nuk u ofroi kush përkrahje as kushtoj vëmendje edhe pse pas nesh gjendet një det me gjak dhe krime, për të cilat Kosova u dashtë të hapte shumë varre në gjithë relievin e saj në mënyrë që tu bënte vend të 14 mijë viktimave të pafajshme shqiptare, një pjesë e të cilave edhe pas rreth 15 vitesh,presin varrhapur, kthimin e tyre në atdhe.

Ndaj,për kontributin e dhënë në zbardhjen dhe përjetësimin e tragjedive të tilla, autorja Luljeta Selimi meriton nderim të veçantë me njërin nga çmimet më të vlershme për të drejtat dhe liritë e njeriut apo ndonjë çmim tjetër të ngjashëm, për pasqyrimin me realizëm të ferrit të jetës së femrave shqiptare në faqet e këtij libri,të cilat edhe pas lufte,nuk guxuan të shprehen asnjëherë deri në fund,ndaj ato ende ndryjnë në zemrat e tyre shumë përjetime të pathëna,të cilat duhet të jenë të afërta me vdekjen dhe tragjedi me dhembje që edhe sot vazhdojnë.

Gani Qarri Cyrih - Soloturn, 24 nëntor 2013

* * *

Krijimtaria letrare e Lebit Murtishit i flet zemrave shqiptare e njerëzore njëkohësisht.

Isuf Ismaili

Poeti, prozatori dhe dramaturgu Lebit Murtishi është nga ata krijues që vargun poetik, fjalën artistike e shoqëron me nota të një harmonie muzikore me ndjeshmërinë shpirtërore, në një përmbledhje ndërthurjesh ideore, nga

edhe më fuqishëm se me ndonjë motiv tjetër shquhet motivi i dashurisë për atdheun dhe përkushtimi ndaj dëshmorëve dhe heronjve, të cilët u flijuan për lirinë e njëmendtë dhe bashkimin e Atdheut.

E tërë vepra e tij jetësore e krijuese është një përkushtim i theksuar ndaj arsimit, kulturës, letërsisë dhe ribashkimit të trojeve të Shqipërisë.

Mësuesi patriot Lebit Murtishi e mbrojti shkollën shqipe në Ladorishtë, me forcat shpirtërore atdhetare të shumëfishuara, përballë policisë e pushtetit shovinist e barbar sllavo- maqedonas. Ai ishte i gatshëm të flijojë madje edhe jetën për shkollën e arsimin shqip, për shkollën e cila u bë vatra jo vetëm e mësimit nga lëndët e shumta shkencore e shoqërore, por u bë edhe shkolla e edukimit njerëzor e atdhetarizmit shqiptar.

Momentet sa krenare aq edhe madhështore për hapjen e shkollës shqipe me forcat fizike e shpirtërore, morale e atdhetare në radhë të parë të prijatarëve a nismëtarëve si Lebit Murtishi Kadri Labënishti, kryeplaku i fshatit, Qemal Lena dhe mësuesit e atdhetarët të tjerë qofshin nga Ladorishta a të vendeve të tjera, kanë gjetur trajtimin artistik tek romani: “Udhët e yjeve” . Ky roman i Lebitit është një përshkrim jo vetëm kësaj ngjarje, por shtrihet në kohë të ndryshme e në vatra të ndryshme shqiptare, ku mbizotëron një harmoni rrëfimtare e meditative e gërshetuar në mënyrë të shkëlqyer si nga ana ideore ashtu edhe nga ana artistike.

Një pjesë e madhe e mësimdhënësve, e në mesin e tyre edhe mësuesi, vëllai e shoku ynë i dashur Lebit Murtishi, u bënë flamurtarët, zëdhënësit dhe edukatorët më të mëdhenj të atdhetarizmit dhe bashkimit të trojeve të Shqipërisë.

Në këto shkolla shqiptare këta mësimdhënës dolën në radhët e para të demonstratave dhe aksioneve, në ballë të manifestimeve, grumbullimeve e veprimtarive jo vetëm për çeljen e shkollave shqipe, por edhe për çlirimin e bashkimin kombëtar, prandaj pushtuesit serbë, maqedonas e malazezë i burgosën i torturuan për vdekje e megjithëkëtë një pjesë e madhe prej tyre mbijetuan. Mbijetoi edhe Lebiti, të cilin kriminelët policë, barbarë sllavo-maqedonas e liruan nga burgu, ngase e kishin torturuar për vdekje, e liruan

që të vdiste në shtëpi, por ai e mundi vdekjen me forcat e pashterura njerëzore e atdhetare dhe kështu së bashku jo vetëm punën e tij praktike e veprën konkrete të aksionit, por edhe me krijimtarinë e tij letrare është pjesë e dritës dhe rrezatimit artistik, është pjesë e pandarë në kurorën e atdhetarizmit shqiptar.

Lebit Murtishi u lind në Ladorishtë, më 1955 në një fshat shqiptar a katund siç i thonë arbërisht, afër Strugës, i cili ngrihet në lartësinë 850 metra mbi nivelin e detit. Është në kufi me fshatin Frëngovë dhe afësisht 2 klm., deri në Qafë Thanë, ku padrejtësisht është vënë kufiri në mes trojeve shqiptare, por që në kuptimin shpirtëror për të gjithë atdhetarët e liridashësit shqiptarë ai kufi as ka ekzistuar dhe as nuk ekziston. Shqipërisë i kemi thënë e i themi Atdheu ynë, aty ku shqiptari gjallëron në trojet e tija brez pas brezi edhe pse armiqtë serbë, sllavo - maqedonas, malazezë e grekë na i pushtuan më shumë se gjysmën trevave shqiptare.

Dhe ja ç`na thotë Lebeti duke evokuar historinë i flet edhe të tanishmes i flet brezave dhe i jep peshën e porosisë atdhetare në artin poetik: Ah për pak harrova!/Ku mbeti Prizreni?/ S`ka më pashallëqe,/Vendosi Kuvendi Shkoni nga të doni,/ Mes për mes t`i bini,/ Një dhe një të vetme,/ Shqipërinë e shihni.

Te libri: “Poezi dhe dy monodrama” 2013, poezia: “Shqipërisë”

Kështu i flet shpirti, kështu i shkruan dora, kështu krijoji vepra që lexuesit shqiptarë të komunikojnë përherë e në kohë të ndryshme me të dhe këta të pasurohen e të begatohen me ide të mëdha e me shije artistike, të marrin frymëzime për të ecur e gjallëruar në botën e lavdisë e krenarisë shqiptare.

Në poezinë e krijimtarinë e tërësishme letrare sado që e hasim motivin lirik, atij më për zemër i shkon motivi epik, heroik, madhështor dhe krijimtaria e tij pikërisht kulmon me përkushtim letrar ndaj heronjve e dëshmorëve të atdheut dhe porosive për jetësimin e synimeve dhe idealeve shqiptare.

Prandaj edhe natyrshëm i derdh vargjet poetike e fjalitë prozaike e dramatike në vepra për heronjtë e Shqipërisë, të cilët u flijuan në luftën heroike të UÇK- ës si Adem Jashari, Fehmi Lladrofci, Tahir Sinani etj.

Tri monodramat për këta tre heronj paraqesin ndërthurjen logjike e harmonike, gjuhësore e letrare në lidhshmëri të pandashme me heroizmin dhe porosinë për jetësimin e ribashkimit të Shqipërisë dhe mbarëvajtjes së saj.

Përmbyllja që i bënë monodramës "Ky dhe ka zot" kushtuar Komandantit Legjendar të UÇK- ës Adem Jashari, janë fjalitë më kuptimplota të ndërlidhura me atë që u tha më sipër.

"Ky dhe ka emër, ky dhe ka Zot

Unë jam Shqipëria që nuk di për mort "

Përveç stilizimit gjuhësor e letrar këtu kemi dhe simbolikën e identifikimit të heroit me Nënë Shqipërinë, së cilës i dha jetë nga jeta e tij dhe pikërisht nga ky heroizëm e flijim dhe heroizma të tjerë rron Shqipëria me heronjtë e saj, që nuk dinë se ç`është morti.

Po kështu edhe tek monodrama "Kosova nuk di të vdesë" kushtuar heroit Fehmi Lladroci shquhet pikërisht përkushtimi atdhetar që shkon aq ndjeshëm në kuptimin e jetësimit të idealeve shqiptare.

Tjetra monodramë: "Këngë prej dheu", kushtuar heroit të kombit Tahir Sinani, i cili mori pjesë në tri luftërat e UÇK- ës, në mënyrë shumë të natyrshme e gjejmë fillim dhe kulmin artistik në vargjet.

Dhe trup e tërthor/ e tërthor e trup/ gjithandej rrugët më çojnë, / përmes Shqipërisë.

Gjuha e veprës letrare të Lebit Murtishit është shumë mirë e latuar, nëpërmjet së cilës ndërthuret e harmonizohet së bashku edhe stilema estetike, edhe figurshmëria e simbolika edhe ritmi, rima dhe përgjithësisht vlera artistike e ideore.

Ai fjalën e nxjerr ëmbëlsisht nga gurra e gjuhës shqipe dhe i drejtohet popullit.

Dritëro Agolli në një artikull ka theksuar: “Poezia si çdo art tjetër, duhet t`u flasë zemrave dhe të bëhet e nevojshme si ajri, uji dhe buka”

Pikërisht edhe Lebit Murtishi padyshim e themi se përveç dellit poetik që e ka, përveç muzikalitetit të ëmbël që shfaq në veprën e tij letrare, ai i flet zemrave njerëzore, lexuesve shqiptarë dhe sidomos poezia e tij ndjehet si ajri i freskët malor.

Solothurn, 24. 11. 2013

* * *



B I S H Z - V A I S - U I A S
BASHKIMI I INTELEKTUALËVE SHQIPTARË NË ZVICËR
VEREINIGUNG DER ALBANISCHEN INTELLEKTUELLEN IN DER SCHWEIZ
UNION DES INTELECTUELS ALBANAIS EN SUISSE
UNIONE INTELLETTUALI ALBANESI IN SVIZZERA

“ Publicistika dhe përditshmëria ...”

Abas Fajzullahi

Lexuesi i vëmendshëm, pas leximit të librit nga autori Xhevat Rexhaj me titull: **„EPOKA E SHËNUAR APO RUGOVA, FLAMURI, LDK-JA“** ku përmes analizave, vështrimeve, kritikave, vlerësimeve dhe reportazhave në vazhdimsi ka përcjellur e përcjell me vëmendje jetën e përditshme dhe rrjedhatë e saj në kohë dhe hapësirë, të njeriut, familjes dhe shoqërisë tue përfshi rolin e tyre në institucione të ndryshme shoqërore e shtetërore, si në trojet etnike të shqiptarëve dhe në gurbet, në veçanti në Zvicër ku autori, jeton, punon dhe krijon…

Autori në 165 titujtë në librin e tij në fjalë në 678 faqe, prek pothuajse të gjitha fushatë e jetës së përditshme, tue u përpjekur në vazhdimsi të përshkruaj gjithë atë që autori e vëren me sy gjithandej ku dhe kah gjindet e kah shtegton, qoftë në vendin ku jeton e punpn në gurbet, apo edhe gjatë pushimeve ku dhe kah i ka kaluar, në atdhe apo pjesë të atdheut të shkëputura me dhunë nga pushtuesit sllavë e grek…

Përjetimet e tija vetanake, emocionet dhe gjithë bisedatë e bëra dhe zhvillimi i rrjedhave jetësore nga përditshmëria,ngjarjeve në kohë dhe hapësirë, ku herë herë e ngacmojnë autorin, e nxisin që të kundërvihet-dhe reagon, kritikonë, veset, sjelljetë, veprimet e të tjerëve dhe vetes, tue bë një gërshëtim shumë domethënës të rrjedhave dhe ngjarjeve nga përditshmëria jetësore, qofshin ato vetanake, familjare, shoqërore dhe institucionale. Bënë krahasime, kritika dhe vlerësime si të veprimeve, qëndrimeve, botëkuptimeve, gjykimeve dhe paragjykimeve mes gjeneratave, tue zbatuar gjithnjë parimet demokratike si për lavdratë dhe kritikë, në bazë të dëshmive, herë herë edhe i dëshpruar bazohet në përditshmërin edhe me ndonjë sharje, por me vend dhe ku duhet e si duhet…

Autori është i lidhur shumë me vendlindjen e tij, dhe koha e kaluar në gurbet dhe ndryshimet e ndodhura pozitive apo edhe negative, i vë në pah në mënyrë të ndërsjelltë, kundërthëniet dhe interesatë, ftohja e marrëdhënieve mes vendorve në atdhe ndaj gurbetqarve… lavdron dhe përkujton të mirat dhe traditen e vendasve por edhe te metat, rikujton ngjarjet historike në të kaluaren dhe ardhmerin e tashme të shtetit më të Ri, Republikën e Kosovës. Kritikon partit politike por edhe partinë të së cilës i takon edhe vet autori, në kuptimin pozitiv me dëshmi e të dhëna, për të gjitha veprimet dhe sjelljet e tyre në kohë dhe hapësirë, tue vu në pah edhe tëmiratë edhe të kqijat që janë me bollek siç thot populli, po druan nga pasojat dhe tëreq vërejtje me kohë... Vlerson dhe analizon rrjedhatë politike në kohë dhe hapësirë, më meritorët në në këtë drejtim e sidomos në fushen e diplomacisë dhe politikbërjes për krijimin dhe themelimin e miqësisë me SHBA si dhe ideologun e shtetësisë së Kosovës Dr.Ibrahim Rogova, ndaj të cilit shpreh një nderim të veçantë nga se përveq se janë nga i njejti fshat që të dy familjet, kanë qenë të ndëshkuara nga pushtuesit serb me vrasje të anëtarëve më të dashur familjar... por gjithnjë tue e lidhur me fatin e përgjithshëm të Dardanisë-Kosovës hallemadhe e të shumë vuajtur.

Autori Xhevat Rexhaj, bënë lidhshmërin e të sotmes me të kaluarën, krahasimet dhe anët që duhet lavdruar i lavdron dhe ato që duhet kritikuar s`i kursen që nga rrethi familjar, shoqëror dhe institucionale në gurbet dhe kudo në trojet e atdheut.

Përcjell me vëmendje rrjedhat në kohë dhe hapësirë dhe në veçanti ato rrjedha e ngjarje me peshë historike po edhe diplomatike ku siç është edhe rasti me kryetarin e parë të Kosovës Dr.Ibrahim Rugova, i cili kreu studimet pas doktoraturës një vitë në Francë te filozofi francez i shekullit të kaluar Bartel, me dituri, urtësi dhe kujdes për atdhe, arrijti për t`ju dëshmuar botës së qytetruar perëndimore qëllimet dhe planet serbe të cilat i udhëheqte AASHS në bashkëpunim dhe bashkëveprim me Kishën Orthodokse Fundamentaliste Serbe, për zhdukjen e qëies bilogjike shqiptare përmes planeve të tyre famkeqe tue fillue prej Ilia Garashaninit, Vaso Qubrilloviqit, Ivo Andriqi dhe Dobrica Qosiqit e iqëve tjerë...

Poashtu ana diplomatike e Dr.Ibrahim Rugovës në rrethana të ndryshme qofshin ato si test apo ngacmim të qëllimshëm që i bëhen në rrethe të ndryshme intelektuale franceze gjatë darkën me 24 lloj ushqimesh(meny) për të parë se si do të sillet ne drekën e shtruat të aristokracisë franceze... Kryetari Dr.Ibrahim Rugova i rritur, edukuar në familje shqiptare me traditë e kultur, në odatë shqiptare ku mirësjellja është traditë si gjatë ushqimit edhe bisedes, edhe drekimin e kreu si duhet, (e nëse ka qenë edhe qëllimi i testimit drekimi) e kreu me sukses, ku në vazhdim e pyesin: "...**Z. Rugova mos keni kryer ndonje shkollim ne diplomaci? E, ai me urtsinëe tije u kthen troq, jo, vetem une u bazova ne kulturën e sjelljes tradicionale në odat shqiptare, ata i shprehin kompliment dhe mbesin sa te mahnitur!..**"

Kritikon sjelljet dhe papërgjegjësitë qofshin ato vetanake, familjare apo edhe kolektive, bënë fjalë edhe për nxënës, student, për bashkim (integrim) dhe prap brenga e Kosovës…e në veçanti në moszhvillimin ekonomik të Kosovës nga qeverisja jo e mirë, dhe pasojatë e shumta nga krimi i organizuar dhe keqpërdorimet(korrupcioni) që ka përfshi në përgjithësi gjitha institucionet e në veçanti qeveritarët...

Ja se si e përshkruan mbingarkimin e administratës në bashkin e vendlindjes së tij e rrethin: "Ta shikojmë administratën publike, në komunat e Kosovës, janë ende ato veset dhe mënyrat komuniste të kryerjes së shërbimeve për qytetarë. Këto i vërejsha në komunën e Istogut, por edhe në 3 komuna tjera, ku unë isha si mysafir, apo si kureshtar. Në një zyre ke 4-5-6 punëtorë, duhani pihet pa kontrolluar, aty ndodhen edhe nja 2 apo 3 mysafirë, duhani frrokë. Në zyrat tjera e njejta gjë, dikush merr rrogën për shkrimin me makinë të dokumentit, tjetri merr rrogë se e nënshkruan dokumentin, ndërsa ai me rradhë merr rrogën se e vulosë dokumentin. Drejtorët e drejtorive, të jem i sinqertë, ende me atë mendjemadhësinë e kaluar, kush jam unë s`eshtë askush?..."

Në librin e autorit Xhevat Rexhaj, mjaft flasin edhe titujt e shkrimeve, të cilët edhe përcaktojnë përmbajtjen e shkrimit, si kritikë, analizë, vështrim, reportazhë, bashëbisedim(intervistë), paraqitje etj. Në vazhdim disa nga titujt e shkrimeve në drejtime të ndryshme të përmendura sipër:"... **LDK-ja,TRI GRUPIME BRENDA NJË STRUKTURE ORGANIZATIVE?!, ZVICRA DHE KOSOVA, FLAMURI NACIONALIZMI, EVROPA E BASHKUAR, SUPER- AUTOSTRADA" IBRAIM RUGOVA", DURRËS-KUKËS-MERDARE, SHQIPËRINË TA DUAM TË GJITHË NJËSOJ!?...,FËMIJËT-PRINDËRIT-MËRGIMI,...ZËRI I HOXHALLARËVE**

TË ULQINIT!...,PASAPORTA ME DHE PA VULËN KUFITARE- "REPUBLIKA E KOSOVËS", FAREFISI DHE REALITETI, FAMILJA DHE RELACIONI NË FAMILJE,BOSHNJAKËT DHE SERBËT, REPUBLIKA E KOSOVËS, A PO KTHEHET SERBIA, PAKËZ, NË SHTETIN E PAVARUR REPUBLIKA E KOSOVËS?, 24 MARSI 1999, 19.45, PËRFUNDOJ ERRËSIRA SHEKULLORE, KADRI MANI –VLERË KOMBËTARE, SHTETARËT ME PAGA MARRAMENDËSE, NË SHTETIN ME PAPUNËSI DHE VARFËRI MARRAMENDËSE, SI E KA LËNË REPUBLIKËN E KOSOVËS, PRESIDENTI YNË, A JEMI SHQIPTARË A MYSLIMANË?!, KU JENI LDK-istë?!, DJEGËJA E FLAMURIT DARDANË MË 2005, ATATURKU E PRICË FARUKU, DUKAGJINI, DRENICA, LLAPI, REPUBLIKA E KOSOVËS, DIKUR DIASPORA E DASHUR, TANI" DIASPORDHA", AEROPORTI I PRISHTINËS ËSHTË EVROPË APO AFRIKË, FAMILJA E MADHE JASHARI DHE PAVARËSIA E NJOHUR,SHQIPTARËT LLAFE SHUMË, PUNËT, MOZOMAKEQ,SHOJ JAKUPI NË SHQIPËRI ME FOTOGRAFIN E E.HOXHËS TË FUTUR NË XHEP,SHQIPTARET NË ZVICË DJE DHE SOT, H.THAç, DALLIMET DHE TË PËRBASHKËTAT, EULEXI- MIRË APO KEQ PËR KOSOVËN?!, ME "TRADHTARË E PATRIOT" U RRASËM NE SHQIPTARËT, SI MUND TË JETOHET NË NJË SHOQËRI, KU VRASËSIT E BURRAVE TË SHQUAR SHQIPTARË, SORROLLATEN LIRSHËM?!, MËRGIMTARËT, APO "AUSLANDERAT" NË SHTETIN E TYRE, PEZA E EDI RAMËS, ZANZIBARI I THAçIT, DHE M.KUSARI KINSE E GJAKOVËS!?, SHQIPTARËT E AMERIKËS DHE PAVARËSIA E KOSOVËS, HAJNAT QË VJEDHIN SHTËPINË VET, JANË MË TË RREZIKSHËMIT!?..., ECJA E HASHIM THAçIT NËPËR TEHUN E THIKËS!?, A I MBETEM BORXH, EDHE SA ISHTE GJALLË, VEPRIMTARIT TË SHQUAR SHQIPTARË, KADRI MANIT?!, A KEMI AKADEMI?!...,SHTETI I VJEDHUR, BËRTASIN HAJNAT!!!... ETJ.

Si përfundim: Autori vazhdon me krijimtari, në fushën e publicistikës me suksesë tue përcjellur vazhdimisht rrjedhat jetësore në gurbet dhe kudo në atdhe…tue i vu në shënjestër të kritikës, të gjitha dukurit negative a pozitive që nga individi, familja, rrethi shoqëror, në punë, në vendet e

punës në institucione të ndryshme civile dhe administrative e deri tek ato shtetërore në Kosovë e më gjërë pa lënë anash edhe rrjedhat në gurbet...

* * *

JETËSHKRIMI I SHKURTËS I LABIT MURTISHIT

Jetëshkrimin e poetit Lebit Murtishi, po e fillojm pakëz më ndryshe nga praktika e deritashme që u lexohet autorëve me rastin e përurimit të ndonjë vepre apo veprave, të ndonjë kremte si ditëlindje etj.

E për këtë ndryshim, apo thyerje rregulle, nëse mund të thuhet kështu me këtë rast, **Lebiti** s`është fajtor edhe nëse provojm ta fajsojm, se mos i bëhet si shumë, nga se në vazhdimsi është fajsuar, përcjellur e përndjekur, pa të drejtë, nga pushtuesi sllavomaqedon, që si ushqim shpirtëror e kishin dhe si duket ende vazhdojnë me të njejten sëmurje të pa shërueshme dhe këshillëtarin më të keq, **urrejtjen ndaj shqiptarëve**, e faj i vetem i **Lebitit** për sllavomaqedonet ishte se lindi shqiptar, u rrit i till në trollin e të parëve të tij, historikisht shqiptar, ku bashkë me rriten, riteshin edhe veprimet e tija, për çështjen e nevojshme kombëtare në përgjithësi siç shkruan në njëren nga poezit e tij**:" Këtu jam që sot e mot..."** dhe me poezin me të cilen po e fillojm edhe jetëshkrimin e tij:

" pak boigrafi...!
jam rritur në rrethojë me tel
Me gjemba
përngjajshëm me një bishë në kafaz
tryelat gjer në shpirt më dëpertuan
që unë të zbutem
si një bishë e mjerë
m`vranë buzqeshjet shpërgënjë
rininë ma gozhduan në zëndanë
po shpirti më përgjakej përmbi tela
dhe mbeta bishë e egër
pa zingjir... "

Lebiti lindi në fillim të muajt Korrtor, ku me të madhe korrën aratë me gruar dhe grumbullohen bereqetet nga puna dhe djersa e bërë nga bujqit e vyerë Veleshtarë. E për familjen Murtishi ,ishin dy gëzime përnjëherë.

Të korrurat verore me bereqet dhe lindja e **Lebitit** nga nëna **Nazmije Lleshi** me gjini dhe nga bab **Ukshin Murtishi.**

A.F

Ndërsa Lebiti jetëshkrimin e vet e paraqet keshtu:

Quhem Lebit Murtishi !

Kam lindur më 01.07.1955 në Ladorisht të Strugës- Republika e Shqipërisë. Për mua, në trojet shiptare nuk ekziston shtet tjetër, pos atyre okupues...Këtë adresë ia kam dhënë policisë italiane në kampin e refugjatëve në Latino të Romës në mars të vitit 1975, e cila u bë shkak për dorëzimin tim në organet kufitare jugosllave në Kopër të Sllovenisë, ku e mbajta edhe dënimin e parë me burg prej 20 ditësh. Për këtë shkak humba të drejtën e shkollimit të rregullt në shkollën e mesme profesionale të muzikës në Prizren...Meqë ishte viti i fundit, me ndihmën e profesorëve, tashmë të ndjerë,Ibish Gashi dhe Dashnor Xërxa,u diplomova për mësues dhe regjistrova ,me korrespondencë kuptohet,akademinë e muzikës në shkup dhe degën e Letërsisë në Prishtinë. Në vitin 1979, pas kthimit nga shërbimi ushtarak u punësova në tetëvjeçaren e fshatit si mësues muzike...Studimet nuk munda t'i përfundoj për shumë arsye, tashmë të„pa shpjegueshme"...Jam thirrur shpesh në„biseda informative „nga policia rajonale për shkak se dërgoja,bashkë me bashkëshorten time,Hamiden,nxënës shqiptarë në shkollat e mesme në Prizren.Hamidja është e lindur në Prizren dhe kjo na e lehtësonte punën gjatë sistemimit të nxënësve,sepse shtëpia e prindërve të saj ishte gjithmonë stacioni i parë ku vendoseshim...

Në vitin 1990 (fillimi i Shtatorit),në Strugë dhe në shumë qytete tjera shqiptare nën jugosllavi, filluan demonstratat masive për të drejta kombëtare,ku theks të veçantë kishte kërkeesa për rihapjen e shkollave shqipe,të cilat ishin mbyllur pas ngjarjeve të vitit 1981.

Kam qënë anëtar i këshillit koordinues të protestave deri sa u shtypën me dhunë nga policia fashiste e gligorovit...Gjatë kësaj periudhe pati edhe incidente me policinë, dhe ndër të tjerë, u dënova edhe unë me dy muaj burg,por kurrë nuk iu përgjigja thirrjes të fashistëve për mbajtjen e dënimit,ngase nuk kisha asnjë obligim qytetar ndaj vrasësve të lirisë dhe të kulturës shqiptare...

Pas shuarjes së protestave gjithëpopullore, me një grup shokësh vendosëm dhe themeluam ,pa lejen e pushtuesve,Gjimnazin e Parë Shqiptar në ato troje - në objektet e shkollës fillore të fshatit tim...Për këtë akt falënderoj publikisht prof.Fehmi Aganin,i cili u angazhua që shkolla jonë të jetë pjesë e ndarë e Gjimnazit,,Hajdar Dushi“të Gjakovës.Dhe kështu filloi kapitulli i ri dhe i mundimshëm i rrugëtimit tonë historik...Kërkesave tona të vazhdueshme për legalizimin e gjimnazit, pushteti fashist i shkupit iu përgjigj me 860 forca speciale dhe me 2000 mijë rezervistë(këto shifra u pranuan zyrtarisht nga ish ministri i brendshëm,lubomir ferçkoski)duke sulmuar fshatin (më 15 qershor 1992),dhe përmes një dhune purorraciste arrestohen rreth 50 persona, ndër ta edhe unë bashkë me babain. Një pjesë të shtëpisë sime, (murin përballë) për shkak se nuk e hapa derën në thirrjen e tyre (ishte mesnatë)e shembën me autoblinda, u futën brenda dhe bënë punën e tyre. Nuk do përshkruaj përjetimet,se është e pamundur, por duhet të theksoj se më kanë infektuar me hepatitis B,dhe pasi më dënuan me 4.5 vjetë burg,për të vdekur në shtëpi,pas dy muajve më liruan të mbrohem në„liri“...Kjo gjendje më detyroi të ik n¨Shqipëri,ku qëndrova dy vjetë,por pasi gjendja e vajzës sime 6 vjeçare u përkeqësua (sipasojë e traumave të asaj dite,pas disa javësh,vajzës sime, Rinës ,i bllokohen veshkët dhe bëri më vonë transplantim në zvicër),kalova në zvicër,ku jetoj edhe sot.Dy djemtë që i lashë te prindërit në Ladorisht, nuk i takova 6 vjetë...Kjo mjafton besoj. Jam autor i 4 romaneve,tri monodrama,një dramë, dy vepra publicistike, një veper me tregime dhe satira si dhe 13 përmbledhje me poezi...
l.murtishi

* * *

Idriz Mehmeti:
Njohja, afria dhe bashkëpunimi me Lebitin



Të nderuar dashamirë të librit
Të nderuar të pranishëm, përshendetje për të gjithë.

Autorin e librave që po përurojmë sot, Lebit Murtishin i cili edhe është bërë sebep që ne të jemi sot bashk, e përshendes dhe e falenderoj shumë për punën e madhe që ka bërë e po bënë, po thuaj në të gjitha fushat e jetës, duke u gjendur gjithnjë pran halleve që kaloi e po kalon populli ynë dhe vëndi ynë, Shqipëria jonë e dashur.

Lebit Murtishi na ka bashkuar edhe herë të tjera, dhe mund të ju them me krenari, secili rast që na bashkoi Lebiti, ishte spontan, i thjeshtë, por shumë kuptimplotë. Duke pas parasysh faktin se të gjithë ne e njohim Lebitin, besoj edhe ju të ndëruar miqë e keni mendimin tim. Pra të gjithë ne që patëm fatin e njohëm dhe u shoqëruam me te, e dim se Lebiti përveq angazhimit me shpirt në politikë, kontribut shumë të qmueshëm dha edhe në fushën e publicistikës e të letërsis.

Tani më duhet të them hapur këtu para jush, se ndihem shumë i privilegjuar që pata fatin dhe e njoha vëllaun tim Lebitin. Fillimisht përmes një shokut ton të përbashkët, një veprimtar dhe ish i burgosur politik, e bashkëvëndas i imi. Ai ishte Tafë Rukiqi. Më vonë e njoha edhe personalisht, dhe e njoha jo vetëm fizikisht, por e njoha edhe gjithë veprimtarin e tij politike, atdhetare dhe së fundi edhe publicistike e letrare.

Lebit Murtishi nuk u muar me politikën se e deshi atë, por meqë politika u muar me Lebitin dhe me popullin e tij, ai u detyrua që të merret edhe me politikën. Kështu ai, në kohën e duhur me mjetet e duhura gjithmonë ishte në nivelin e detyrës që kërkonte koha. Dhe koha kërkonte djem të ditur, të ngritur, të vendosur e të përcaktuar për të dhënë gjithçka nga vetja e tyre, edhe shëndetin edhe jetën, për Atdheun dhe lirin e tij. Kështu Lebiti u rreshtua aty ku e kërkonte vëndi, dhe pa modesti më duhet të them se ai politikisht, ndërshmërisht çdo herë i shërbeu e po i shërben Atdheut, në mënyrën më të mir të mundëshme.

Nëqoftëse politikisht diti u rreshtua dhe shërbeu çdoherë aty ku duhej e si duhej, ajo nuk ishte meritë as dhunti vetëm e tij, ajo gjithësesi ishte meritë në radhë të parë e familjës së tij dhe e rrethit që e ngriti, ia trasoi rrugëtimin dhe e edukoi në frymën e Atdhedashuris. Mirëpo ka edhe diq tjetër. Lebitit nuk i mjaftoi të qenënit në shërbim të vëndit vetëm politikisht, nga fakti se ai kishte edhe një dhunëti tjetër, kishte një dhunti të dytë, në mënyrë që ta plotësonte këtë të parën, politikën, e dhuntia e dytë ishte talenti i tij në fushën e publicistikës dhe letërsis, të cilën dhunti e shfrytëzoi me mjeshtri të rrallë, duke na dhuruar kështu libra e libra, por gjithësesi, libra që përveq që i shërbejnë ngritjës së vetëdijës për Atdhedashuri ato i shërbejnë edhe historis dhe kulturës në përgjithësi.

Të nderuar të pranishëm, posa të lexoni librat e Lebitit, do shihni se në poezitë e tij, jo secila poezi por seicili rresht ka një mesazh, sa të fortë aq edhe kuptimplotë. Talenti i tij në fushën e letërsis, poezitë, dramatë dhe monodramatë, për dëshmorët dhe heronjët, na i sjellin Ata të gjallë para nesh, dhe na bëhët sikur flasim, komunikojmë e jetojmë me ta. Monodramatë, për Komandant Adem Jasharin dhe Komandant Fehmi Lladrovcin, përveq që i kam lexuar kam pasur fatin dhe i kam pa edhe në skenë. Më besoni të ndëruar të pranishëm, më bëhëj se jam duke jetuar me ta. Ndërsa Monodramën për dëshmorin Tahir Sinanin nuk e kam par akoma në skenë por pata fatin dhe e kam lexua. Dhe mundë të ju them gjatë leximit sikur kisha ndjenjën se me Komandant Tahirin po qëndroja bashk në malet e Berishës, aty në Kleqkën Legjendare. Kështu Tahir Sinani më dukej njeriu më i fort e më i bukur në gjithë botën Shqipëtare, dhe më gjërë.

Të ndëruar miq e ndjejë dëtyrim të ju njoftojë se, edhe unë me takatin tim jam përpjekur të sjellë para lexuesve të nderuar dy libra me kujtimet e mija që kan të bëjnë kryesisht me luftën e Ushtris çlirimtare të Kosovës. E para titullohet Si e njoha Adem Jasharin ndërsa e dyta titullohët Ata ishin Një, (bëhët fjalë për Komandant Shkabën, Fehmi Lladrovcin dhe Xhevën, Shotën e ditëve tona), dhe ndjehem shumë i nderuar që pata privilegjën, që për të dyja librat, Redaktor e pata Lebit Murtishin, ndaj me këtë rast dua ti bëjë edhe një falënderim të veqantë autorit të librave që po përurojmë sot dhe redaktorit të dy librave të mi, të ndëruarit Lebit Murtishit. Njëherit shfrytëtoi nga rasti që një falëndërim shumë të madh ti bëjë familjës së nderuar Murtishi, poashtu vëllait Xhemaili Murtishit i cili me mjeshtri të rrallë përmes këngës së bukur Shqipe, sidomos këngët e bukura për Dëshmorët dhe Heronjët por edhe shumë poezi të Lebitit na i solli në skenën mozikore. Gjithësesi një falenderim i shkon edhe Strugës sonë të dashur, perllës së Shqipëris që lindi dhe rriti këtë burr, i cili na e ka zdritë fytyrën e po na e zdritë çdoherë si në politikë ashtu edhe në publicistikë dhe në fushën e letësis. Ju falemnerit.

Tani do të recitoj njërën nga poezit e Lebitit të cilën unë e kam të përzgjedhurë nga zemra ime, ndaj e kam shkruajtur edhe në librin tim ,,Si e njoha Adem Jasharin” !.

Tre Ademë i fali Zoti

Krijuesi i mbikohsgëm,
Tre Adema i dha botës.
Një i fali njerëzisë,
Kur Atdheu kishte zjarre,
Baca tundi kazamatet.
Kur Atdheu ra të vdes,

Dy të tjerë Shqipërisë. Baca fali mijëra jetë.

Në Prekaz Ademi tjetër,
Veshur me barot e hekur.
Që Shqipërisë ti zgjatët jeta,
Dogji Kullat me gjithë Djepa.

Vuajtja për Diellin e munguar
apo
Lebit Murtishi dhe stinët pa Diell

Gani Qarri

Kur flasim për këtë autor,që në fillim të këtij vështrimi,kam nderin të shprehem me kënaqësi, se fjala është për një krijues të dalluar dhe atdhetar të devotshëm shqiptar nga treva e dashur e Iliridës i cili për shumë kohë jeton dhe vepron në Zvicër.

Pra, në këtë shkrim të shkurtër flitet për poetin, prozatorin, dramaturgun dhe veprimtarin e mirënjohur të çështjes kombëtare, zotëri Lebit Murtishi, i cili problemin e etnisë sonë të coptuar e sheh si një dhe të pandarë, ndaj po-ashtu, ai edhe i gëzohet trimërisë dhe kryengritjes së çdo pjese të saj.

Në librat e tij kudo, spikat dashuria për atdheun, vuajtja për pjesët e robëruara të tij,brenga për ëndrrën e parealizuar, si dhe malli për vendlindjen e kombin me shumë plagë. Aty, më mirë se kudo tjetër,ai paraqet qartë dhe me sinqeritetin më të madh, atë që për shumë kohë e mundon, si në poezinë "Kosovë",ku kaloi disa vite rinie,gjeti fatin jetës dhe mbaroi një pjesë të shkollimit,për kryengritjet e të cilës ai gëzohet dhe shprehet me krenari:

Ti s`pate kohë të lësh për nesër
u ngrite peshë mbi carë e krajlë
dhe s`ngrite kurrë flamur të bardhë!

Ndaj,gjatë shfletimit të librave të Lebitit,lexuesi vazhdimisht ndjenë se si në poezitë e shkruara nga ai, nuk ka vetëm vuajtje,por edhe përpjekje për liri siç ka edhe këngë e jetë. Madje aty sikur nuk lëvizin vetëm personazhet, por edhe vargjet bashkë me dorën e poetit, të cilave armiqtë më kot u thonë të ndalojnë dhe heshtin kur ato vejnë bijtë në ballë të stuhive për hapjen e udhëve të pranverës së atdheut. Në raste si këto, bijtë e popullit të tij, shpërfillin edhe perënditë, siç shkruan poeti në poezinë "Kënga e Popullit tim"

kur gjëmove mbi gjëmime
e në ballë vure bijtë
e i hape udhë pranverës
e shpërfille perënditë

Siç kemi rastin të bindemi edhe nga porosia domethënëse e këtyre vargjeve,shprehjet e krijuesit, sikur duan të veprojnë, të flasin, dhe këndojnë të papenguara, hapësirave të atdheut. Edhe ato, njëjtë si poeti, përpiqen të bien theror për vendlindjen, kombin dhe lashtësinë e trojeve të tij,pjesë të të cilit,mjerisht edhe sot i mbulojnë **stinë pa diej**, për ç`shkak vazhdojnë të vuajnë trojet e Arbërit bashkë me autorin, si në poezinë "Dhimbje arbërore" në të cilën ai me dhembje shprehet:

Sa këngë në mes u prenë
e kurrë më s`u kënduan
sa dhembje ka madhështia
Arbëri veç ti e di.

Pra, ashtu si shumë bashkëkombësve nën pushtim edhe Lebitit i mungon ngrohtësia e shenjt e lirisë dhe ai lëngon për ëndrrën e parealizuar të dritës në shumë pjesë të atdheut të cilat si në poezinë "Mbaj mend", edhe sot vuajnë për:

Stinët pa diej dhe
ëndrrat e mbetura peng.

Madje,këtë autor dhe veprimtar të përkushtuar të çështjes kombëtare, pa mëdyshje më shumë se çdo gjë tjetër e mundon pesha e rënd e ndarjes dhe okupimit të trojeve të tij, të cilat ai vazhdon ti kujtoj me dhembje si në poezinë "Këngë e Besëlidhjes"

e ç`këngë të këndoj o Lezhë e lashtë
për ty që të përgjakën çdo gurë
në ç`këngë të përkujtoj masën tënde
që mblodhe Shqipërinë nën një Flamur

Vargjet e Lebitit kanë aq shumë peizazhe malli dhe ndjeshmëri shpirtërore,saqë me gjithë pamundësinë për shndërrimin e tyre të menjëhershëm në një realitet të shenjt lirie, shtruar mbi horizonte të gjera ëndërrimtare, mesazhet e dhembshme,për ata që u sakrifikuan për lirin e atdheut,do mbeten përherë në mbamendje, si në poezinë kushtuar Kadri Labënishtit për të cilin thotë:

Për vete i zgjodhe prangat
Që nder tu bënë gjer në varr
****

Dhe ike një ditë me vjeshtën
Në gjirin e Dheut të shenjtë.

Pra autorin e rëndojnë shumë brenga, megjithëse në këtë sferë të mundimshme, ai nuk është i vetëm, e vuajtjet e tij- janë edhe tonat, të cilat do të ruhen të gjalla në zemrat e të gjithë atyre lexuesve që do të kenë rastin ti shijojnë poezitë mbresëlënëse të Lebit Murtishit.

Veprat e këtij autori, të cilës do gjini qofshin ato, poezi,dramë apo roman,janë një kontribut i çmuar, për publicistikën e popullit tonë dhe fushën e letërsisë shqiptare në përgjithësi.

Lebit Murtishi, me artin e shkrimit dhe kujdesin mjeshtëror, tërë qenien pa asnjë kursim, ia kushtoi mallit ndaj atdheut shprehjes së çiltër kombëtare dhe forcës goditëse të fjalës shqipe,e cila në formën se si ai e skalit, ajo qanë edhe gurin.

Ndaj,nga vuajtjet që ndjenë sidomos Shqipëria Etnike apo "Nën e lashtë", siç e quan Lebiti, me gjithë plagët e shpërndara të cilat i therin në gjithë trupin e saj të coptuar, përmes vargjeve të autorit,ajo edhe në ditët më të vështira, do ti shkruaj një këngë Kosovës e cila thotë:

me gjithë dhembjet që kam në trup
një në Plavë e një në Shkup
dhe pse më therin duar e këmbë
për ty Kosovë do shkruaj një këngë....

Pra,jehona e vargjeve që për vite të tëra thur ky poet, nuk njeh përjashtim as kufizime. Si shprehja e shpirtit ashtu edhe fjala e zemrës së hapur të tij, kalërojnë ballëhapur,kudo në të gjitha trojet tona etnike,për të cilat autori ka vetëm një emër të përbashkët, e ai është; Emri i shenjtë - Shqipëri!

Poezia e Lebitit mund të cilësohet si një himn i shkruar në mënyrë inteligjente dhe me stil të veçantë për vendin e kombin që i takon, ndaj edhe njëherë te "Nën e lashtë"me gjithë zemër e himnizon Shqipërinë si atdheun e

përbashkët të të gjithë shqiptarëve, e cila- autori ka dëshirë të na bashkoi edhe me këngë në prehrin e saj amnor, si në këto vargje:

do thur një këngë
t`ia themi bashkë
se jam Shqipëria
jam nën e lashtë

Krijimet e shquara dhe mosha, bashkë me përjetimet nga më të ndryshmet që ai gjatë jetës kaloi, e shndërruan poetin në Portret të Argjendtë i cili me shkëlqimin shpirtëror dhe patriotik të tij, rrezaton kolorite ylberi kudo ka shqiptar.

Ai,përpiqet ti ruaj dhe përtërijë të gjitha pjesët e trungut të coptuar kombëtar nëpër kohë, si Çamëria,për të mos shkuar drejt harresës vuajtjet që ajo hoqi,i cili në dy vargjet e para të Poezisë "Çamëri" na rikujton torturimin që andartët e pabesë grek, i bënë asaj:

Të lidhën për një shekull këmbë e duar
Të lidhën bij andartësh të pa besë,

për ti dhënë asaj në dy vargjet e fundit peshën e kujtimit të përjetshëm dhe cilësinë e nderit të pavdekshëm të Nënës së lashtë Shqipëri:

Por mbete e pavdektë përmbi vdekje
O nder i Shqipërisë që s`di të vdesë!

Për shkrimet e Lebit Murtishit, ka edhe shumë çka të thuhet, por i vetëdijshëm se me një vështrim të vetëm, nuk mund të përmblidhet e gjithë krijimtaria e gjerë dhe e bujshme e tij,shpreh bindjen se veprat e tij, vërtetë meritojnë një vlerësim të veçantë edhe nga kritika jonë.

Ato,jo vetëm se kanë pasuruar,por edhe ngritur e lartësuar krijimtarinë tonë letrare.

Ndaj, unë si autor i këtij vështrimi,me kaq e përfundoj këtë shkrim të shkurtër mbi **Vuajtjet për Diellin e munguar në stinët e pa diell të Lebit Murtishit dhe shumë bashkëkombësve tanë nën pushtim**, duke u ndjerë tejet i nderuar **që në këtë ditë të shenjtë**, mu dha mundësia ti bëj një përshkrim modest, jetës dhe punës së tij të çmuar.

Pra kolegë dhe pjesëmarrës të nderuar, kjo ishte e gjithë ajo sa munda të përgatisja kësaj radhe për këtë autor të çmuar.

Ndaj, juve dhe gjithë mysafirëve në këtë tubim u falënderohem përzemërsisht për kujdesin dhe vëmendjen e treguar.

Gani Qarri, Cyrih - Soloturn, 24 Nëntor 2013.

****

GANI QARRI

Gani Bajram Qarri lindi më 25 mars të vitit 1962 në fshatin Demjan të Hasit në Kosovë.
Shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse atë të mesme dhe studimet e larta drejtimi Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, i mbaroi në Shkollën e Lartë Pedagogjike, tani Fakulteti i Edukimit "Bajram Curri" në Gjakovë.
Pas diplomimit, nuk iu mundësua punësimi si mësimdhënës nga organet komuniste të shkollës," me arsyetimin e papërshtatshmërisë politike",siç arsyetonin komunistët shqipfolës të kohës. Ndaj,ai do të detyrohej që të punonte përkohësisht si punëtor në fabrikë.
Duke mos u pajtuar asnjëherë me regjimin e kohës,pas shkruarjes së parullave për "Kosovën Republikë", në fabrikën ku punonte, atij do ti pamundësohej qëndrimi në vendlindje,ndaj do të merrte rrugën e mërgimit dhe vendosej në Zvicër.
Gani Qarri jeton dhe punon për rreth 26 vite në Cyrih të Zvicrës,i cili gjatë viteve 1996-1997 do të përpiqej që për afro dy vite të kontribuonte aq sa mundej duke punuar si mësimdhënës me nxënësit shqiptarë në shkollën me mësim plotësues në gjuhën shqipe për fëmijët e emigrantëve shqiptar, të cilët kishin ardhur në Zvicër nga të gjitha trojet tona etnike.
Përveç përkujdesjes për mbajtjen e familjes dhe shkollimit të fëmijëve, Gani Qarri merret edhe me shkrime dhe krijimtari poetike. Vitin e kaluar botoi përmbledhjen me poezi "Mallkim Shekujsh" dhe në pranverën e këtij viti librin me përmbajtje historike në prozë "Krijuesit e Historisë" (Nga lindja e ëndrrës për liri deri te realizimi i Idealit për Pavarësi).
Ai, kohë pas kohe, merret edhe shkrime opinioniste të cilat i boton nëpër gazeta dhe portale të ndryshme shqiptare.

Deri tani ka botuar veprën poetike:
1."Mallkim shekujsh", poezi.
2."Krijuesit e Historisë", prozë, mars 2012, botoi ndërmarrja shërbyese "Jeta e re"

Krijuesit e historisë së përvjetorëve të mëdhenj".



VRASJE IDEALESH

Abas Fejzullahi Soloturn, 24 nëntor 2013.

Manifestimet si ky, i përkushtohen me gëzim e krenari dhe pietet të lartë "Pavarësisë Kombëtare" të cilën e arritëm falë krijuesve historik të këtyre përvjetorëve të mëdhenj, në kuptimin gjithëpërfshirës të krejt etnisë

sonë, siç edhe kremtohet çdo përvjetor i saj- nga të gjithë shqiptarët kudo, tash e 101 vite me radhë.
Megjithëse në kohën kur ajo ndodhi,nuk qe shpall as proklamua si *Pavarësi e kufizuar kombëtare* nga shqiptarët, Fuqitë e Mëdha të kohës, vendosën ta njihnin pavarësinë vetëm për hapësirat e vizatuara me dorën e tyre të lirë, që përfshiu pjesën e mbetur brenda kufijve të Shqipërisë londineze,në Konferencën e Ambasadorëve të vitit 1913, në Londër.
Por, edhe për arritjen e lirisë dhe realizimin e Pavarësisë së Shqipërisë së sotme,u flijuan qindra mijëra shqiptar, njëjtë siç u flijuan edhe dhjetëra mijëra tjerë për Pavarësinë e Kosovës,me të cilat, për fat të keq nuk u realizuan të gjitha aspiratat kombëtare për çlirimin dhe bashkimin në një shtet të përbashkët të të gjithë etnisë dhe trojeve tona në Ballkan.
Ndaj,për burrat që na sollën deri këtu,për heronjtë e luftës dhe diplomacisë, u shkruan shumë libra, kronika e dokumentar nëpër kohë, të cilat sado të shumta që mund të jenë, nuk mjaftojnë të thuhet e gjithë ajo sa ata bënë për këtë vend dhe komb.
Në mesin e adhuruesve të mishëruar me veprat e mëdha të emrave më të merituar të historisë sonë, bënë pjesë edhe kolegu ynë këtu z. Gani Qarri,si autor i dy librave modeste në prozë mbi këto figura të veçanta dhe të pazëvendësueshme për vendin dhe popullin tonë.
Ata ishin heronjtë të cilët dhanë gjithçka nga vetja dhe bartën barrën kryesore në periudhat më të vështira e vendimtare të historisë, për çlirimin e vendit dhe pavarësinë e atdheut në mënyrë që edhe shqiptarët të kishin shtetin dhe arrinin lirinë e tyre kombëtare.
Më 2011, Gani Qarri përgatiti përmbledhjen me poezi "Mallkim Shekujsh" të cilën e botoi "Jeta e Re" në Prishtinë. Ndërsa dy librat e tij në prozë, "Krijuesit e Historisë" u botua **në Mars të vitit 2012,**kurse "Vrasje Idealesh" doli nga shtypi **në Gusht të vitit 2012.**
Derisa tek libri poetik, "Mallkim shekujsh", historia jonë vjen e shtjelluar në vargje, në veprat e tij në prozë, botuar në prag të festës së 100 vjetorit të pavarësisë së shtetit shqiptar, përshkruhet jeta dhe vepra madhore heronjve kryesor të popullit tonë cilët dhanë çdo gjë nga vetja për gjuhën,kombin dhe lirinë e shqiptarëve, gjatë shekujve XIX, XX dhe XXI,duke pasuruar kështu edhe më tej literaturën tonë me tematik historike dhe ndjesi atdhetare.
Libri "Krijuesit e Historisë" me nëntitull; "*Nga lindja e ëndrrës për liri,deri te realizimi i idealit për pavarësi*", ka rreth 300 faqe, dhe përqendrohet kryesisht tek heronjtë e Lidhjes Kombëtare të Prizrenit, atyre të arritjes

së Pavarësisë së Shqipërisë dhe Kosovës, duke filluar nga Ymer Prizreni, Abdyl Frashëri,Mic Sokoli, Mehmet Shpendi,Dedë Gjo Luli, Isa Buletini,Hasan Prishtina,Bajram Curri, Luigj Gurakuqi, Ismail Qemali e shumë të tjerë mbi 20 sosh, deri te heroizmi i Familjes Jashari.
Ndërsa libri "Vrasje Idealesh" edhe ai me rreth 350 faqe,për nga përmbajtja që ka, mund të konsiderohet si plotësim i të parit, ku përshkruhet jeta,vepra dhe vdekjet e rënda edhe të mese 25 heronjve tjerë kombëtar, si të atyre që krijuan alfabetin dhe shkruan gjuhën tonë,ashtu edhe për ata që luftuan për liri e bashkim kombëtar,të cilët asnjëherë nuk ndaluan përpjekjet me grykën e pushkës dhe majën e pendës, derisa u flijuan në mënyrat më të dhembshme për çështjen kombëtare shqiptare.
Emrat e tyre, siç e cek në një vend edhe autori, nuk përfaqësonin vetëm luftën e një populli të robëruar, por edhe vetë idealet e ëndërruara ndër shekuj të shqiptarëve- për gjuhë, shtet dhe liri kombëtare, me vrasjen e të cilëve, armiqtë mendonin të varrosnin edhe shpresat e paraardhësve tanë për çlirim, duke filluar që nga Dervish Cara i cili i pari nga të gjitha personalitetet historike të hapësirës sonë etnike,me pushkë në dorë do të kërkonte shtetin autonom shqiptar.
Ndaj libri" Vrasje Idealesh" fillon me shkrimin mbi kryengritjen e Dervish Carës dhe idealin e tij për liri dhe shtet kombëtar, trimëritë e Oso Kukës,përpjekjet e Naum Veqilharxhit, Papa Kristo Negovanit, Petro Nini Luarasit ,për shkruarjen, ruajtjen dhe kultivimin e gjuhës shqipe si ideale të jetës së tyre. Luftën e Shotë dhe Azem Galicës, Çerçiz Topullit etj, për çlirim. Flijimin e Marie Shllakut, Prof. Ymer Berishës,aktet e larta patriotike nga Haki Taha e Halim Spahija ,mbytjen në burg të Bedri Pejanit,veprën e madhe dhe vdekjen e dyshimtë të Mithat Frashërit,e shumë të tjerë që punuan dhe luftuan gjatë gjithë jetës për idealin e bashkimit kombëtar.
Me një fjalë në dy librat në prozë, rreshtohen heronjtë më të njohur shqiptar,që ranë për idealin e lirisë dhe pavarësinë e Shqipërisë, Kosovës, Iliridës dhe të gjitha trojeve tona etnike, megjithëse nuk u arrit e gjitha ajo për të cilën ata me mish e me shpirt u përpoqën, luftuan dhe vdiqën trimërisht.
Ata ishin heronj që qëndruan si burrat, edhe atëherë kur u tradhtuan nga gjaku i tyre, pas të cilëve Pavarësia e ëndërruar, mjerisht edhe në shekullin XXI,mbetet e pa realizuar për të gjithë shqiptarët.
Këto vepra me tematik historiografike, autori i botoi me rastin e 100 vjetorit të shtetësisë shqiptare,dhe rrumbullakimit të një Shekulli

Pavarësie të Shqipërisë së sotme, derisa pjesë të konsiderueshme të kombit dhe toka të mëdha të tij,pa të drejtë mbahen ende nën sundimin e shteteve të huaja.
Ndaj në librin me poezi "Mallkim Shekujsh" përveç shprehjes së dashurisë kombëtare që kumbon në çdo varg,autori shpreh edhe pezëm të pafund…duke shkuar deri në mallkim kohërash (shekujsh), që si NËMË kobzezë ndaj kombit tonë, lanë shqiptarët të ndarë, kurse trojet e tyre të copëtuara, një pjesë bukur e madhe e të cilave edhe sot vuan nën pushtim.
Në dy librat e tij me përmbajtje historike, si "Krijuesit e Historisë" **botuar në Mars të** vitit 2012 nga "Jeta e Re" në Prishtinë, ashtu edhe në veprën "Vrasje Idealesh" botuar në Gusht të vitit 2012,nga shtëpia botuese "Vllamasi" në Tiranë,të gjitha shkrimet,rrezatojnë patriotizmin sublim të shumë brezave nga të gjitha trojet shqiptare, heroizmi i të cilëve mundësoi që përveç Shqipërisë "londineze" liria e ëndërruar, gjatë gjithë historisë së ekzistencës sonë kombëtare, para pak vitesh të shijohet edhe në Kosovë!
Si ilustrim të përmbajtjes së veprës "Vrasje Idealesh", po sjellim pjesë të parathënies së përgatitur nga poetja e mirënjohur Raimonda Moisiu e cila në mes tjerash shkruan:
<u>Pjesë nga parathënia e Librit:</u>
Një derë hyrjeje për në"Labirintin e fshehtësive"
Parathënie
Sa e sa herë "më është marrë fryma" nga ngutja për t'i shkuar sa më parë deri në fund.....dorëshkrimin e ardhur prej një profesionisti mbas vitesh të tëra hulumtimi nëpër biblioteka dhe arkiva, të dëshmuara këto me referenca literaturore, si brenda paragrafësh, ashtu edhe në fund kapitujsh..... të cilat, siç e bëjnë librin tronditës e mësazhpërcjellës, e bëjnë të besueshëm për gjithkënd.
Duke i hedhur një sy biografisë krijuese të autorit, orientohesh se materialet janë shkruar e publikuar në çaste të ndryshme të një vije kohore të gjatë, por në libër ato janë ndërthurur dhe kompozuar si një e tërë.
Kësisoj, ai mund të lexohet si një libër i plotë prej lexuesish kureshtarë, ndërsa për biblioteka studiuesish e hulumtuesish mund të shërbejë për referenca të herëpashershme, duke e përdorur kësisoj si "Lexicon"personash e ngjarjesh.
Jo më kot në faqet e para i bëhet vend i veçantë figurës madhore të Naum Veqilharxhit, siç jo më kot libri mbyllet me portretin e një tjetër figure madhore, atij të Mit'hat Frashërit....këtu ....nis zbardhja e shumë vlerave .....

të historisë sonë kombëtare si Naum Veqilharxhi, Oso Kuka, Petro Nini Luarasi, Shtjefën Gjeçovi, Papa Kristo Negovani, Mit'hat Frashëri, etj,...vlera e gjuhës, kulturës, etnosit, etj:..... qoftë edhe para një detaji si ky i jetës së monumentalit Naum Veqilharxhi: Edhe pse dihet kompleksiteti i raporteve të tij me fisin,...Tri vajzave të veta do t'u vinte emrat Miranda, Saranda, Luljeta.
Ndërsa, po të futeshim në trajtesat mbi figura dhe ngjarje madhore të tilla si: Dervish Cara, Kadri Prishtina, Sadik Rama, Iljaz Agushi, Shaban Polluzha, Mehmet Gradica, Masakra e Tivarit, Ymer Berisha, Marije Shllaku, Haki Taha, Ukë dhe Shaban Sadiku, Hajdar Maloku, Xhemë Hasa (Gostivari), Idriz Gjilani, Ndue Përlleshi, Bedri Pejani, Halim Spahia, etj,....do të tronditeshim me çfarë është bërë në kurriz të popullit tonë dhe historisë sonë, ...
në realizimin e skenave të tilla, shpeshherë bashkautorë.....kanë qenë edhe vetë shqiptarët ....
Si i tillë, ky libër, që vjen në vigjilje të Jubileut të Madh të 100 - Vjetorit të Shtetit Shqiptar, do të shërbejë sadopak për të ndriçuar mendjet e shqiptarëve të tanishëm me kujtesë të sterilizuar vetëm në kufirin e propagandës sllavo -komuniste,.....
Dhëntë Zoti të shërbejë si referim edhe për instancat e larta shtetërore që të respektojnë, nderojnë dhe dekorojnë vlerat e vërteta dhe jo ata që kanë përgjegjësi të mëdha për katrahurën që i është shkaktuar historisë dhe burrave të mëdhenj të kombit tonë.

Tiranë, korrik 2012 Raimonda Moisiu
****

Ju faleminderit!

Abas Fejzullahi Soloturn, 24 nëntor 2013.

* * *

Letra përshëndetëse

FW: Fatbardha Demi An: Abas Fejzullahi
Von: **Veprimtarja Pejone (veprimtarja01@hotmail.com)**
Gesendet: **Montag, 11. November 2013 19:28:20**
An: **Abas Fejzullahi (abas_fejzullahi@hotmail.ch)**
Date: Mon, 11 Nov 2013 13:25:56 +0000
From: fatbardha_demi@yahoo.com
Subject: Fatbardha Demi
To: veprimtarja01@hotmail.com
Pershendetje Behide, po te dergoj imeilin tim per zonjen Luljeta Selimin
E kalofshi sa me mire ne takim

Fatbardha

E dashur Luljeta Selimi,

Nën Tereza, duke ju drejtuar njerëzve që kanë patur fatin të përjetojnë padrejtësinë dhe egërsinë e një shoqërije, shteti apo force të errët e çdo ngjyre qoftë, ka shkruar: «Do të doja të ndezësh një qiri, se sa të mallkosh erësirën !»

Kjo grua e vogël shqipëtare, që ia kishte falur zemrën Zotit dhe gjithë njerëzimit, bënte thirrje për VEPRIM në emër të JETËS.

Pushtuesit serb, synuan të vrisnin dëshirën për Jetën dhe Lirinë tek shqipëtarët, duke zhdukur dhe dhunuar shpirtërisht dhe fizikisht vajzën, motrën, gruan dhe nënën e tyre.

Libri juaj « Rrëfime tronditëse - Femrat e dhunuara gjatë luftës në Kosovë » dëshmon se edhe një njeri, mund të ndezë, një dritë të fuqishme, mbi faktet reale të luftës në Kosovë dhe mbi historinë e femrave të vrara, sakatuara, torturuara dhe të braktisura, siç i kish bërë nëna, në mes të rrugës. Kjo dritë e fuqishme zbuloi fytyrën e lyer me makiazhin politik, të «bashk-jetesës europiane» me kriminelët e papenduar e të padënuar, të shtetit serb e aleatëve të tyre.

Shumë-kush, jo vetëm në vëndet e huaja, por edhe në gjirin e shqipetarëve të Shqipërisë, Malit të Zi, Maqedonisë, Greqisë e në botë, nuk e kanë njohur panoramën e vërtetë të kësaj lufte, për faj të çensurës së interesave politike.

Ndërkohë që në Francën e shekullit të 21, ngrihet memoriali në kujtim të tregëtisë së skllevërve dhe genocidit ndaj popullsisë afrikane të para shumë shekujve, kur në Gjermani kampet shfarosëse të nazizmit janë bërë vënde peligrinazhi nga e gjithë bota, kur organizohen data përkujtimore të viktimave të luftrave kriminale në çdo shtet të Europës, për viktimat femra të popullsisë shqipëtare të Kosovës nuk flet kush, nuk ka një monument, nuk ka një ditë përkujtimore, nuk kanë vlerësimin që meritojnë dhe mbështetjen për t'iu kthyer jetës normale në Kosovë.

Kjo «harresë» është e pafalshme, sidomos për dy shtetet shqipëtare, atë të Kosovës dhe të Shqipërisë, në damarët e popullsisë të të cilëve rrjedh i njëjti gjak si ay i viktimave femra.

Botimi i librit «Rrëfime tronditëse - Femrat e dhunuara gjatë luftës në Kosovë» është një ndihmesë e rëndësishme, për organet e drejtësisë së Kosovës (EULEX'in), për t'u kthjelluar dhe bërë dallimin e kriminelit nga viktima dhe luftën çfarosëse, nga lufta për vet-mbrojtje dhe të drejtat e njeriut.

Ju përshëndes juve për librin që keni botuar dhe veprimtarinë humanitare që zhvilloni, aktivisten Behide Hasanajn dhe shumë të tjerë, që me punën e tyre, ju kthejnë shpresën, optimizmin dhe dinjitetin, viktimave femra të luftës çfarosëse të shtetit serb.

Me respekt

Fatbardha Demi

11.11.2013

****

From: jusuf_osmani@hotmail.com
To: gjenozid.9899@hotmail.ch
Subject: RE: Tungjatjeta
Date: Mon, 11 Nov 2013 17:11:54 +0000

Bashkimit te Inelektualve Shqiptare ne Zvicer.

Ju falenderoj ne ftesen per pjesemarrje ne aktivitetet e Shoqates se Juaj. Por, per arsyra shendetesore nuk mund te marri pjese. Mirepo, iu deshiroj suksese dhe pune te mbar. Jam i gatshem te bashkepunoj me Shoqaten e Juaj, duke iu derguar librat e mia te botuara (42 libra) qe kane te bejne per vendbanimet e Kosoves, per te kaluaren historike te Kosoves dhe libra profesionale nga lemia e arkivistikes. Posaqerisht mund t'iu dergoj libra per krimet e Serbise ne Kosove (ne gjuhen shqipe dhe angleze). Per veprimtarine time shih ne faqen e Internetit (te dhenat ne google).

Theksoj se znj. Behide Hasanaj ka kontribuar mjaft shume ne aspektin humanitar ne ndihma viktimave te luftes dhe per grumbullimin e te dhenave perkitazi me kete. Ajo ka dorezuar ne Arkivin Shteteror te Kosoves nje sasi te konsideruar te dokumenteve arkivore per krimet serbe ne Kosove dhe ndihmat nga diaspora.

Prishtine 11.11.20013.

Me respekt

J. Osmani

.....

MBYLLJA E PROGRAMIT PËR PJESËN E PARË

Të nderuar pjesëmarrës,

Në emër të BISHZ- dhe të kryesisë së punës, u jemi mirënjohës dhe u falënderojmë për pjesëmarrje dhe përcjelljen e pjesës së parë të programit lidhur me përurimin e veprave nga katër autorët.

Para se ta përmbyllim këtë pjesë të programit i falënderojmë autorët e librave dhe referuesit me vështrimet e tyre.

Në jetë në të gjitha periudhat historike, janë bërë përurime të ndryshme nga lëmi të ndryshme, si në artë, kulturë e shkencë, me këtë rast po e përmbyllim këtë përurim të librave, me një vlerësim përmbyllës:

Në jetë ndodhin fenomene natyrore me fuqi shkatrruese, por edhe veprime njerëzore, po ashtu me veprime shkatrruese, siç janë: Tsuname, dridhje të tokës, uragane, vërshime, si dhe fatkeqësi të tjera nga faktori njeri si përdorimi i bombës atomike në Hiroshim... bombardimet e ndryshme , dhe si pasoj e këtyre, janë dëmtuar apo zhdukur vendbanime të tëra, qytete e fshatra, ndërtesa e ura siç ishin edhe Ura e gurit në Mostarë nga bombardimet Serbe të viteve 1990-ta, Ura e gurit që qëndroi shekuj me rradhë në Prizren, nga vërshimet e ujrave nëntoksore të bashkuara me Lumbardhin u zhduk në vitin 1979, kullat binjake në SHBA ... etj! Mirëpo veprat që lënë autorët, dhe shpërndahen nëpër biblioteka, apo edhe tek lexuesit anë e këndë botës, janë të pa zhdukshme sepse i shpëtojnë këtyre fatkeqësive dhe i kanë shpëtuar që nga kohërat e lashta e deri më sot, andaj edhe këtë përurim po e mbyllim me shpresë se edhe këto libra do i

qëndrojnë kohës dhe do depërtojnë tek lexuesit dhe institucionet e ndryshme kulturo-arsimore...

Faleminderit për vëmendje.

Abas Fejzullahi - Kryetar i BISHZ

Solothurn, 24. 11. 2013

© Pashtriku.org, 28 Nëntor 2013